



# USHTRIA



Viti i 73-të i botimit Nr. 34 (827681)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 28 Gusht 2020

## Zjarret në vend-AKMC shkresë Bashkive dhe Policisë



### Merrni masa për parandalimin e zjarreve, të ndëshkohen përgjegjësit

Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile (AKMC) i ka drejtuar në mbydhje të javës që kaloi, ditën e shtunë, datë 22 gusht, dy shkresa respektive 61 bashkive, 12 prefekteve dhe Policisë së Shtetit lidhur me situatën e zjarreve në vend. Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile (AKMC) u kërkon bashkive që

të marrin masa të plota për parandalimin dhe minimizimin e dëmeve nga zjarret. Po ashtu iu kërkon edhe prefektëve të përdorin të gjitha kapacitetet operacionale në nivel qarku, për të përballuar këto situata. "Pushteti vendor të japë informacion në kohë reale për shfaqjen e vatrave të zjarrit. Bashkitë... >> faqe 2

Shqipëri-Mali i Zi: Komision për shenjat në kufirin shtetëror

## Helikopteri "Cougar" vendos shenja dalluese në liqenin e Shkodrës



>> faqe 3

## Gjeneralmajor Bajram Begaj takon nënkolonel Erol Munir

# Gjeneralmajor Begaj: SHBA-kontribut të rëndësishëm në modernizimin e FARSH

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjeneralmajor Bajram Begaj, priti shefin e Zyrës së ODC nënkolonel Erol Munir >> faqe 3



## Ligji "Për mbrojtjen civile"

### Zjarret: Roli i prefektit të qarkut dhe kryetarëve të bashkive

Prefekti i qarkut ka rol parësor në zvogëlimin e risikut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile në nivel qarku. Përveç detyrave të përcaktuara në ligjin për prefektin e qarkut, prefekti i qarkut ka dhe këto detyra: të kthejë buxhetin e vitit pasardhës të bashkive brenda territorit administrativ të tij, në rast se nuk janë planifikuar fondet buxhetore...



>> faqe 4

## Akademia e Forcave të Armatosura

### Karakteristikat e programit të studimit "BACHELOR"

Programi mësimor "Studime në Shkenca Ushtarake" për tre vitet 2020-2023, është program studimesh universitar i ciklit të parë i organizuar në lëndë e module dhe i vlerësuar në kredite sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Disiplinat mësimore dhe aktivitetet e tjera formuese janë të organizuara në pesë... >> faqe 5



NATO

### Stoltenberg: Ne jemi të shqetësuar për situatën në Mesdheun lindor

>> faqe 8

FIGURA HISTORIKE

### Nikoll Kota, patriot i çlirimit kombëtar

PROF. ASOC. DR. BERNARD ZOTAJ >> faqe 6

HARTOGRAFI GJOVANEZ BARTOLOMEO PARETO

### Ja harta e rrallë Detare e Arbërisë e vitit 1455

>> faqe 15





ZJARRET NË VEND-AKMC SHKRESË BASHKIVE DHE POLICISË

# Merrni masa për parandalimin e zjarreve, të ndëshkohen përgjegjësit

*Gjatë kësaj periudhe ka patur zjarre në shumë zona të vendit ku janë angazhuar efektivë dhe helikopterë të Forcave të Armatosura*

**A**gjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile (AKMC) i ka drejtuar në mbydhje të javës që kaloi, ditën e shtunë, datë 22 gusht, dy shkresa respektive 61 bashkive, 12 prefekteve dhe Policisë së Shtetit lidhur me situatën e zjarreve në vend.

Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile (AKMC) u kërkon bashkive që të marrin masa të plota për parandalimin dhe minimizimin e dëmeve nga zjarret. Po ashtu iu kërkon edhe prefektëve të përdorin të gjitha kapacitetet operationale në nivel qarku, për të përballuar këto situata.

“Pushteti vendor të japë informacion në kohë reale për shfaqjen e vatrave të zjarrit. Bashkitë të zhvillojnë trajnime detyruese për punonjësit lidhur me situatat e zjarreve. Bashkitë të mbajnë në gatishmëri dhe të përdorin të gjitha kapacitetet zjarrfikëse. Në bazë të ligjit, Bashkitë, vullnetarët dhe vetë qytetarët, janë kapacitetet për shuarjen e vatrave të zjarrit.”, thuhet në shkresën për bashkitë dhe prefekturat.

Shkresën tjetër AKMC ia ka nisur Policisë së Shtetit, ku kërkohet që të vihen para përgjegjësisë zjarrvënësit.

“Të merren masa për zbulimin e autorëve të zjarreve, qofshin ato me dashje apo dhe nga pakujdesia. Zjarrvënësit të ndëshkohen sipas përcaktimeve të Kodit Penal. Zbulimi i autorëve ul numrin dhe madhësinë e zjarreve. Ndëshkimi i autorëve ndërgjegjëson qytetarët se zjarrëvënia është krim. Kërkohet koordinim me pushtetin lokal dhe kryeqendrën për identifikimin



Pushteti vendor të japë informacion në kohë reale për shfaqjen e vatrave të zjarrit. Bashkitë të zhvillojnë trajnime detyruese për punonjësit lidhur me situatat e zjarreve.

e autorëve. Të ndiqen me prioritet zjarrvëniet duke informuar publikun për autorët e tyre.”, - thekson

AKMC në shkresën për Policinë e Shtetit.

Gjate kësaj periudhe ka patur

zjarre në shumë zona të vendit ka janë angazhuar efektivë dhe helikopterë të Forcave të Armatosura,

nuk ka pasur dëme në njerëz, por fatkeqësisht shumë pemë janë djegur, si ne: në zonën e Kasharit, pranë fshatit Kus në Tiranë; në Portëz të Bashkisë së Fierit; në vendin e quajtur “Godull”, masivi pyjor Seman, në bashkinë Fierm, ku nga flakët, është përfshirë një kodër me ullinj dhe shkurre; në fshatin Fullqet të Bashkisë Klos; në zonën e Salarisë në Tepelenë, në Picrragë të Fushë-Krujës, në qarqet Lezhë, Elbasan, Vlorë.

STAFI

**DED KOLA**  
Shef i Sektorit të  
Botimeve & Kryeredaktor

**Gazetarë:**  
Mimoza **GOLIKJA**

**Gazetarë:**  
Saimir **ALIJA**

**Graphic Designer:**  
Afërdita **HYSAJ**

**ADRESA:**  
Rruga e Dibrës/  
Garnizoni “Skënderbej”



## Gjeneralmajor Bajram Begaj takon nënkolonel Erol Munir

## Gjeneralmajor Begaj: SHBA-kontribut të rëndësishëm në modernizimin e FARSH

*Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjeneralmajor Bajram Begaj, priti shefin e Zyrës së ODC nënkolonel Erol Munir*

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjeneralmajor Bajram Begaj, priti më 20 gusht 2020, në një takim shefin e Zyrës së ODC, në Tiranë, nënkolonel Erol Munir, i cili shoqërohej nga atasheu ushtarak i SHBA në vendin tonë, CDR James Hilton.

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjeneralmajor Bajram Begaj, gjatë takimit e falënderoi nënkolonel Munir për kontributin që Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë dhënë në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes, në ndërtimin e kapaciteteve ushtarake të FARSH. "SHBA kanë një kontribut të rëndësishëm në modernizimin e

FARSH, duke e mbështetur në shumë projekte si: mjetet taktike të blinduara; helikopterët Black Hawk; Bazën Ajrore të Kuçovës; Njësinë e Mbrojtjes Kibernetike; mjetet taktike të komunikimit

...". theksoi ndër të tjera gjeneralmajor Begaj. Në përfundim të takimit gjeneralmajor Begaj i uroi suksese të mëtejshme në detyrën si shefi i ri i Zyrës së ODC dhe në karrierën ushtarake.



Komandës Mbështetëse në zonën Kuz Baba, Vlorë

## Ekipi i EOD eleminon pesë predha nga Lufta e Dytë Botërore

Në zbatim të urdhërit të shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA, për dërgimin e një ekipi EOD, për çaktivizimin, heqjen dhe asgjësimin e municioneve të gjetura në zonën Kuz Baba, Vlorë, gjatë punës së ujësjesit e kanalizimeve të zonës, ekipi EOD i Komandës Mbështetëse mori masat e nevojshme për zbatimin e detyrës.

Pasi mori kontakt me Drejtorinë e Policisë, Vlorë dhe me zbatuesin e projektit në zonën e punimeve për kalimin e tubacionit, vijoi puna për pastrimin e zonës nga municionet e hasura, të cilat i përkisnin Luftës së Dytë Botërore (LIIB).

Pesë predhat e gjetura të kalibrit të madh (100 mm) u transportuan menjëherë në Drejtorinë e Policisë Vlorë, duke kryer edhe krehjen e zonës përreth, për municione të tjera të mundëshme. Për arsye se projekti i ujësjesit vazhdon, u komunikua me përfaqësuesit e firmës zbatuese që në rast konstatimi të prezencës së municioneve të tjera në ditët në vijim, të njoftojnë menjëherë nëpërmjet Drejtorisë së Policisë, Vlorë. Zona ku u krye operacioni ishte me bimësi.



SHQIPËRI-MALI I ZI: KOMISION PËR SHENJAT NË KUFIRIN SHTETËROR

## Helikopteri "Cougar" vendos shenja dalluese në liqenin e Shkodrës

*Sipas marrëveshjes mes dy qeverive, pala shqiptare është përgjegjëse për instalimin dhe mirëmbajtjen e 11 bovave, ndërsa pala malazeze për 10 të tilla*

Peshkatarët shqiptarë dhe malazezë, por edhe policitë kufitare të të dy vendeve do ta kenë më të lehtë të orientohen dhe të dallojnë vijën kufitare gjatë lundrimit në liqenin e Shkodrës. Sipas njoftimit të Forcave Ajrore shqiptare, përgjatë ditës së enjte, date 20 gusht 2020, në Liqenin e Shkodrës nisi operacioni për vendosjen e bovave përgjatë kufirit ndërshtetëror liqenor me Malin e Zi, ku në ditën e parë, helikopteri "Cougar" i Forcës Ajrore shqiptare realizoi me sukses uljen nga ajri të tre bovave.

Komisioni i përbashkët për rindërtimin dhe riparimin e shenjave në vijën e kufirit shtetëror Shqipëri-

Mali i Zi, ku bëjnë pjesë Shërbimi Hidrografik i Forcës Detare, Instituti i Gjeografisë dhe Infrastrukturës Ushtarake dhe Policia Kufitare, vendosën në mirëkuptim të plotë me palën malazeze 6 bova (shenja të reja dalluese në liqen).

Vendosja e bovave u krye fizikisht nga një helikopter "Cougar" i Forcës Ajrore. Kufiri mes Shqipërisë dhe Malit të Zi në liqenin e Shkodrës përcaktohet nga 21 bova, të cilat për shkak të kushteve atmosferike dhe mungesës së mirëmbajtjes ishin dëmtuar dhe nuk ekzistonin prej vitesh.

Pas katër ditësh, pra në datë 24 gusht, Forcat Ajrore kishin vendosur në liqenin e Shkodrës 6 bova, 3 prej

të cilave me ndriçues natën për të bërë më të dallueshëm kufirin shqiptaromalazez. Kjo do u shërbejë peshkatarëve të dyja vendeve dhe policive kufitare. Ministrja e Mbrojtjes Olta Xhaçka thotë se bovat në liqenin e Shkodrës ishin dëmtuar prej kohësh dhe nuk funksionin, prandaj në mirëkuptim me palën malazeze u vendosën shenjat e reja dalluese. "Peshkatarët shqiptarë dhe malazezë por edhe policitë kufitare të të dy vendeve do ta kenë më të lehtë të orientohen dhe të dallojnë vijën kufitare gjatë lundrimit në liqenin e Shkodrës. Helikopterët e Forcës Ajrore, në mirëkuptim të plotë me palën malazeze lëshuan 6 bova të reja



(shenja dalluese në liqen), ndër të cilat 3 me sinjal ndriçues për natën, të cilat ishin dëmtuar dhe nuk funksiononin prej vitesh".

Sipas marrëveshjes mes dy qeverive, pala shqiptare është përgjegjëse për instalimin dhe mirëmbajtjen e 11

bovave, ndërsa pala malazeze për 10 të tilla. Dy vitet e fundit pala jonë ka bërë rivendosjen e 8 shenjave të reja ujore në kufirin me Malin e Zi në liqenin e Shkodrës, ndër të cilat 3 me sinjal ndriçues për natën.

PJESË NGA LIGJI “PËR MBROJTJEN CIVILE”

# Zjarret: Roli i prefektit të qarkut dhe kryetarëve të bashkive

*Sigurojnë funksionimin e sistemit të monitorimit, mbajnë në gatishmëri sistemet e mbrojtjes nga zjarri, dhe informojnë në kohë komunitetin dhe Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile*

Prefekti i qarkut ka rol parësor në zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile në nivel qarku. Përveç detyrave të përcaktuara në ligjin për prefektin e qarkut, prefekti i qarkut ka dhe këto detyra: të kthejë buxhetin e vitit pasardhës të bashkive brenda territorit administrativ të tij, në rast se nuk janë planifikuar fondet buxhetore për marrjen e masave për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, sipas parashikimeve të nenit 65 të këtij ligji; kryen vlerësimin e risqeve në territorin e qarkut përkatës, duke hartuar dhe miratuar dokumentin e vlerësimit të riskut nga fatkeqësitë në nivel qarku, i cili i dërgohet Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile për qëllim analizimi dhe planifikimi; koordinon veprimtarinë e organeve, institucioneve dhe strukturave që veprojnë në nivel qarku, me qëllim zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile dhe pas ezaurimit të të gjitha kapaciteteve brenda qarkut për përballimin e emergjencës civile ose fatkeqësisë, i kërkon ndihmë për ndërhyrje Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile; bashkëpunon me bashkitë për realizimin e vlerësimit të riskut nga fatkeqësitë në qark, si dhe për informimin e publikut e të komunitetit të rrezikuar nga fatkeqësitë në lidhje me to; harton, miraton dhe përditëson Planin për Emergjencat Civile në qark dhe e dërgon në Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile për qëllim analizimi dhe planifikimi; grumbullon dhe përpunon të dhënat e nevojshme nga bashkitë dhe strukturat e tjera që veprojnë në nivel qarku, për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, si dhe informon në mënyrë të vazhdueshme Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile; siguron funksionimin e sistemit të monitorimit, paralajmërimit të hershëm, njoftimit dhe alarmit në territorin e qarkut dhe informon në kohë komunitetin e rrezikuar, prefektët e qarqeve fqinje, si dhe Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile për fatkeqësitë në territorin e qarkut; merr masat e nevojshme për përballimin dhe lehtësimin e pasojave nga fatkeqësitë; koordinon shpërndarjen e asistencës ndërkombëtare në rastet e fatkeqësive në nivel qarku; përcakton prioritetet për nevojat e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, investimet emergjente të nevojshme në nivel qarku, me qëllim parandalimin, mbrojtjen dhe rehabilitimin nga fatkeqësitë; krijon bazën e të dhënave të humbjeve nga fatkeqësitë në nivel qarku, të cilën e mirëmban dhe e përditëson, si edhe shkëmbejnë informacione me Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile dhe, sipas rastit, me prefektët e qarqeve fqinje; koordinon forcat operacionale në nivel qarku në rastet e fatkeqësive dhe cakton drejtuesin e operacionit në nivel qarku; bashkëpunon me bashkitë e qarkut dhe me prefektët e qarqeve fqinje, në zbatim të detyrave që lidhen me zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, me qëllim bash-



kimin e kapaciteteve të tyre për trajtimin e çështjeve të përbashkëta në këtë fushë; angazhon kapacitetet brenda qarkut për përballimin e situatave të krijuara nga fatkeqësitë, si edhe qytetarët. Në rast emergjence civile apo fatkeqësie, ka për detyrë të realizojë përhapjen dhe shkëmbimin e informacionit me AKMC-në, njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe prefektët e qarqeve të tjera të prekura ose të rrezikuara, si dhe të promovojë e të koordinojë marrjen e masave të nevojshme për përballimin e situatës, monitorimin dhe zbatimin e shërbimeve urgjente, aktivizimin e institucioneve dhe administratave për ndërhyrje specifike; kontrollon zbatimin e masave të marra nga bashkitë e qarkut për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile; i drejton kërkesë për mbështetje AKMC-së, sipas kërkesës së bërë nga bashkitë. Në çdo qark, nën drejtimin e prefektit të qarkut, krijohet dhe funksionon komisioni i mbrojtjes civile. Në çdo bashki, nën drejtimin e kryetarit të bashkisë, krijohet dhe funksionon komisioni i mbrojtjes civile. Përbërja, funksionimi dhe detyrat e komisioneve, miratohen me urdhër të prefektit/kryetarit të bashkisë.

Kurse bashkitë kanë këto detyra: kryejnë vlerësimin e risqeve në territorin e tyre, duke hartuar dhe miratuar dokumentin e vlerësimit të riskut nga fatkeqësitë, të cilin ia dërgojnë prefektit të qarkut dhe Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, për qëllime analizimi dhe planifikimi; informojnë publikun

dhe komunitetin e rrezikuar, bazuar në dokumentin e vlerësimit të riskut nga fatkeqësitë; hartojnë dhe rishikojnë strategjinë për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë; hartojnë, miratojnë dhe përditësojnë planin vendor për emergjencat civile dhe ia dërgojnë Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile dhe prefektit të qarkut, për qëllime analizimi dhe planifikimi. organizojnë veprimtari trajnuese në fushën e mbrojtjes civile për punonjësit dhe banorët në territorin e tyre; sigurojnë

funksionimin e sistemit të monitorimit, të paralajmërimit të hershëm, të njoftimit dhe të alarmit në territorin e tyre dhe informojnë në kohë komunitetin e rrezikuar, Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile dhe prefektin e qarkut për fatkeqësitë në territorin e qarkut; sigurojnë, administrojnë dhe përditësojnë të dhënat e nevojshme për shtetasit dhe për subjektet private, të mundshme për t'u planifikuar dhe angazhuar në parandalimin dhe përballimin e fatkeqësive; krijojnë bazën e të

dhënave të humbjeve nga fatkeqësitë për territorin e bashkisë, të cilën e mirëmbajnë dhe e përditësojnë, si edhe shkëmbejnë informacione me prefektin e qarkut dhe Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile; kryejnë investime parandaluese, mbrojtëse dhe rehabilituese nga fatkeqësitë dhe informojnë për këto investime në mënyrë të vazhdueshme prefektin e qarkut, si dhe Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, caktojnë drejtuesin e operacionit në nivel bashkie për përballimin e fatkeqësisë në territorin e saj; kryejnë vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë në territorin e tyre, vlerësimin e nevojave për përballimin e tyre, si dhe dëshmipërblejnë shtetasit për fatkeqësitë e ndodhura në territorin e tyre; bashkëpunojnë me bashkitë fqinje në zbatim të detyrave që lidhen me zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, me qëllim bashkimin e kapaciteteve të tyre për trajtimin e çështjeve të përbashkëta në këtë fushë. mbajnë në gatishmëri sistemet e mbrojtjes nga zjarri, kalueshmërinë e pandërprerë të rrugëve rurale, vendet e strehimit, si dhe mbledhin dhe administrojnë rezervat ushqimore për njerëzit dhe gjënjë e gjallë. Aktivizojnë kapacitetet e subjekteve publike e private brenda territorit administrativ të tyre, bashkëpunojnë dhe asistojnë bashkitë fqinje dhe marrin çdo masë tjetër të nevojshme për përballimin dhe lehtësimin e fatkeqësive. Mbajnë në gatishmëri infrastrukturën e ujitjes, të kullimit, të mbrojtjes nga përmytja dhe digat e rezervuarëve në administrim të tyre.





## AKADEMIA E FORCAVE TE ARMATOSURA

# Karakteristikat e programit të studimit "BACHELOR"



Programi mësimor "Studime në Shkenca Ushtarake" për tre vitet 2020-2023, është program studimesh universitar i ciklit të parë i organizuar në lëndë e module dhe i vlerësuar në kredite sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Disiplinat mësimore dhe aktivitetet e tjera formuese janë të organizuara në pesë kategori lëndësh nga A deri tek E, ku bëjnë pjesë lëndët bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore, plotësuese dhe detyrime përmbyllëse. Gjatë vitit të fundit të studimeve, studenti përgatit një temë diplome, për të cilën vlerësohet nga një komision i ngritur nga Fakulteti i Sigurisë dhe Mbrojtjes. Disiplinat mësimore, veprimtaritë dhe detyrimet akademike vlerësohen me kredite ECTS. Veprimtaritë formuese që janë pjesë e programit "Bachelor" në shkenca ushtarake ndahen si më poshtë: mësim në auditor (leksione, seminare, stërvitje me ndihmën e kompjuterëve, stërvitje komando shtabi, prezantime, zgjidhje detyre, ushtrime praktike); përgatitje individuale (hulumtim, kërkim, studim, punim detyrash e projektesh, përgatitje për provim, përgatitje e tezës së diplomës, etj.); veprimtari të tjera formuese të lidhura ngushtë me profesionin e ushtarakut të tilla si përnjohje terreni, analizë beteje, stërvitje fushore, vizitë mësimore, fushim dimëror e veror, praktikë në trupa, etj. Karakteristika të programit.

Programi i studimeve "Bachelor" në shkenca ushtarake ka karakteristikat e

mëposhtme: është program me kohë të plotë, me një kohëzgjatje normale trevjeçare dhe në fund të tij mund të fitohen 180 kredite; procesi mësimor është i organizuar në vite akademike; studenti që ndjek studimet me kohë të plotë fiton deri në 60 kredite në vit; viti akademik zgjat 30-32 javë mësimore, i ndarë në dy semestra; semestri zgjat 15-16 javë mësimore; java mësimore është pesë ditë (e hënë-e

premtë); çdo ditë mund të zhvillohen deri në 5 orë mësimi; studenti zhvillon jo më shumë se 25 orë mësimore/në javë, në auditor; koha e fillimit, koha e mbarimit, sesionet e provimeve, pushimet, festat zyrtare përcaktohen në kalendarin akademik, i cili miratohet çdo vit. Ndarja e krediteve sipas kategorisë së lëndëve. Sasia e krediteve që duhet të marrë studenti që ndjek këtë program studimi për

përfundimin e tij janë si më poshtë: 27 kredite (ECTS) për kategorinë A të lëndëve bazë, përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme; 99 kredite (ECTS) për kategorinë B të lëndëve karakterizuese, përgatitje për disiplinën shkencore; 22 kredite (ECTS) për kategorinë C të lëndëve ndërdisiplinore/integruese, nëndisiplina, profile dhe grup lëndësh me zgjedhje; 28 kredite (ECTS) për kat-

egorinë D të lëndëve plotësuese, gjuhë e huaj, njohuri informatike, praktika profesionale; 4 kredite (ECTS) për kategorinë E, detyrime përmbyllëse për punimin dhe mbrojtjen e tezës së diplomës. Numri i përgjithshëm i lëndëve së bashku me praktikën në trupa (profesionale) është 36 (tridhjetë e gjashtë) orë që zhvillohen në tre vite akademike. Provimet e studentëve organizohen sipas moduleve.

## LEGJISLACIONI NE FUQI

## Politikat e privatësisë dhe mbrojtja e të dhënave personale

*Ministria e Mbrojtjes dhe Forcat e Armatosura, si pjesë e administratës shtetërore janë subjekt përpunues i të dhënave personale, konform legjislacionit në fuqi*

Ky dokument ka për qëllim informimin e subjekteve të të dhënave personale mbi mënyrën e grumbullimit, përpunimit, përhapjes, ruajtjes së privatësisë dhe masave të sigurisë, për të dhënat e përpunuara nga faqja jonë "web", procese të cilat realizohen në përputhje të plotë me përcaktimet e kuadrit ligjor dhe nënligjor, për mbrojtjen e të dhënave personale. Ky dokument ka për qëllim informimin e subjekteve të të dhënave personale mbi mënyrën e grumbullimit, përpunimit, përhapjes, ruajtjes së privatësisë dhe masave të sigurisë, për të dhënat e përpunuara nga faqja jonë "web", procese të cilat realizohen në përputhje të plotë me përcaktimet e kuadrit ligjor dhe nënligjor, për mbrojtjen e të dhënave personale.

Baza ligjore: Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Rekomandimi i komisionerit për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale, nr. 2, datë 11.05.2020 "Për publikimin e 'politikave të privatësisë' në faqet zyrtare të internetit nga institucionet e administratës shtetërore". Ligjin Nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar. Ligjin Nr. 9918 datë 19.05.2008 "Për komunikimet elektronike dhe postare" si dhe aktet e tjera nënligjore në plotësim. Udhëzimin nr. 47 datë 14.09.2018 të komisionerit "Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga subjekte përpunuese të mëdha. Rregullorja "Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, miratuar me urdhër të ministrit të Mbrojtjes, nr. 1369, datë 25.08.2015. Udhëzimin "Politikat për sigurinë e sistemeve të ndërlidhjes dhe teknologjisë së informacionit", të miratuar me urdhër të ministrit të Mbrojtjes, nr. 770, datë 12.05.2015.

Ministria e Mbrojtjes dhe Forcat e Armatosura, si pjesë e administratës shtetërore janë subjekt përpunues i madh i të dhënave personale, në kuptim të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar. Ato kanë si detyrim plotësimin e të gjitha parashikimeve të mësipërme ligjore në kryerjen e grumbullimit, përpunimit të të dhënave personale duke respektuar dhe garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe në veçanti, të drejtën e ruajtjes së privatësisë.

Kontrolluesi Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura grumbullojnë dhe përpunojnë të dhënave personale, në mënyrë të drejtë, sipas kërkesave të Ligjit Nr. 9887 datë 10.03.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar, duke u fokusuar në:

Grumbullimin dhe përpunimin e të dhënave personale, për qëllime specifike, të përcaktuara qartë sipas ligjit. Mbrojtjen e interesit jetik të subjektit të të dhënave gjatë grumbullimit dhe përpunimit të të dhënave, duke mos tejkaluar qëllimin e përpunimit. Përmbytjen e detyrimit ligjor të kontrolluesit në saktësinë e të dhënave, përditësimin, fshirjen dhe korrigjimin e të dhënave të pasakta, në lidhje me qëllimin e grumbullimit apo përpunimit të tyre. Ndjekjen e interesave legjitime të kontrolluesit ose të një pale të tretë, së cilës i janë përhapur të dhënat, përveç kur këto interesa cenojnë privatësinë e subjektit të të dhënave personale. Mbajtjen dhe ruajtjen e të dhënave të subjekteve për aq kohë sa i vlejnë qëllimit për të cilin ato janë grumbulluar apo përpunuar më tej.

Përpunimi i të dhënave personale bëhet: për të mbrojtur interesat jetike të subjektit të të dhënave; për përmbytjen e një detyrimi ligjor të kontrolluesit; për mbrojtjen e interesave jetësore të subjektit të të dhënave; për kryerjen e një detyre ligjore me interes publik ose ushtrimin e një kompetence të kontrolluesit ose të një pale të tretë, së cilës i janë përhapur të dhënat; për përmbytjen e një kontrate, për të cilën subjekti i të dhënave personale është palë kontraktuese, apo për ndryshime të një kontrate me propozimin e subjektit të të dhënave. Të dhënat personale që grumbullohen dhe përpunohen nga kontrolluesit, janë të dhëna sensitive dhe të dhëna të përbashkëta. Për të dhëna sensitive ekziston detyrimi i veçantë për kontrolluesin (përpunuesin) që të marrë pëlqimin me shkrim të subjektit të të dhënave personale.

Subjekti kontrollues kryen transferim ndërkombëtar të të dhënave personale, me pëlqim të subjekteve të të dhënave personale në vende me nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes të të dhënave personale, bazuar në parashikimet e nenit 8 dhe

9 të Ligjit nr. 9887/2008 dhe aktet nënligjore, të dala në zbatim të tij. Me pëlqim të subjekteve të të dhënave personale, transferohen të dhëna në shtete që nuk sigurojnë nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale, por që autorizohet nga akte ndërkombëtare, të ratifikuara nga RSH dhe që janë të zbatueshme në mënyrë të drejtpërdrejtë si dhe marrëveshjeve të bashkëpunimit, të lidhura nga Ministria e Mbrojtjes, me kusht që këto të dhëna të trajtohen dhe të ruhen, në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

Subjekti i të dhënave personale ka të drejtë që të njihet në çdo kohë me të dhënat e tij personale të grumbulluara dhe të përpunuara, nga kontrolluesi. Subjekti i të dhënave personale informohet nga kontrolluesi për kategoritë e të dhënave personale që përpunohen, qëllimin, mënyrën si dhe çdo informacion tjetër për të siguruar një përpunim të drejtë. Subjekti i të dhënave personale ka të drejtë të kërkojë akses mbi të dhënat e tij, kur informohet se të dhënat e tij po përpunohen; të kërkojë bllokimin, korrigjimin ose fshirjen e të dhënave, me kërkesë, pa pagesë, kur vihet në dijeni se të dhënat rreth tij nuk janë të rregullta, të vërteta, të plota ose janë grumbulluar dhe përpunuar në kundërshtim me dispozitat e ligjit; të informohet nga kontrolluesi brenda 30 ditëve, për kryerjen ose jo të të bllokimit, korrigjimit ose fshirjes, duke u dhënë shpjegimet përkatëse, të kundërshtojë, në çdo kohë, mbështetur në ligj, përpunimin e të dhënave rreth tij, sipas shkronjave "d" dhe "dh" të nenit 6, të ligjit nr. 9887/2008, përveç kur parashikohen ndryshime me ligj; të ankohet në rast se pretendon që i janë shkelur të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshëm për të dhënat personale, ose të njoftojë komisionerin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe të kërkojë ndërhyrjen e tij. Subjekti kontrollues është i ndërgjegjshëm për rëndësinë dhe sensitivitetin e të dhënave personale, me

staf të përkushtuar, të trajnuar në njohjen e kuadrit ligjor dhe i certifikuar për këtë qëllim. Të dhënat personale të subjekteve përpunohen në mënyrë manuale dhe elektronike, në zbatueshmëri të plotë me masat e sigurisë fizike të informacionit dhe sigurisë elektronike nga skedarët spiun, të përcaktuara në rregullore dhe udhëzime të veçanta. Kontrolluesit, përpunuesit e tjerë të të dhënave personale, janë të kufizuar dhe kontrolluar nga kontrolluesi kryesor i përpunimit të të dhënave personale. Në momentin e aplikimit, aplikantëve ju bëhet e ditur, afati i ruajtjes së të dhënave personale.

Të dhënat personale të aplikantëve që nuk shpallen fitues, ruhen deri në përfundimin e afatit të përcaktuar, më pas shkatërrohen (asgjësohen) dhe fshihen nga sistemi.

Çdo person që vepron nën autoritetin e kontrolluesit, përpunon të dhëna personale, nënshkruan një deklaratë kofidencialiteti, me anë të së cilës angazhohet se do të zbatojë kërkesat e ligjit dhe të kësaj politike për ruajtjen e privatësisë, dhe sigurinë e të dhënave personale gjatë ushtrimit të detyrës dhe pas mbarimit të saj. Subjekti kontrollues identifikon adresat dhe numrat e kontakti të subjekteve të të dhënave, për qëllime të caktuara apo të ndonjë ankese nga ana e tyre. Subjekti kontrollues i mundëson subjektit të të dhënave personale të drejtën e refuzimit me shkrim të pëlqimit të dhënë, në çdo kohë.

Subjekti kontrollues kërkon miratimin (pëlqimin) nga subjekti i të dhënave personale që ky i fundit ka marrë dijeni dhe jep pëlqimin për përpunimin e të dhënave sipas përcaktimeve në politikën e privatësisë. Subjekti kontrollues ruajnë privatësinë e të dhënave personale, përditësimin e politikës së privatësisë herë pas herë, duke njoftuar edhe subjektet e të dhënave për ndryshimet e realizuara.





PROF. ASOC. DR. BERNARD ZOTAJ

**Takim me poetin dhe patriotin e madh Naim Frashëri**

Nikoll (Kol) Kota ka lindur në qytetin e Korçës më 15 prill 1858, në një familje atdhetare me tradita të shquara qytetare. Të parët e tij, morën pjesë në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare dhe mbështetën krijimin e “Shoqërisë së Stambollit”. Aleksandri, babai i tij kur ishte nxënës, shpërndau në Korçë “Evëtarin” e Naum Panajot Bredhit (Veqilharxhit) dhe më pas u bë tregëtar i dëgjuar në Korçë dhe Egjipt. Ditën që erdhi Jani Vreto në Egjipt, shumë shqiptarë që kishin frikë nga “kon-sulltoret” greke, nuk u paraqitën t’a takonin, ndërsa shumë të tjerë i kontribuan me napolona flori për botimin e librave shqip. Midis shqiptarëve patriot që nuk i druhej turkomanëve e grekomanëve ishte Nikoll Kota.

Nikolla nuk u mor me tregëti, por në moshën 19 vjeçare doli malit për të kullotur bagëtinë e familjes. Në malet e Korçës, Voskopojës e Vithkuqit, ra në kontakt me individ (kaçak), që kundërshtonin ligjet e administratës Osmane. Për këtë arsye, administrata osmane e shpalli “kaçak”. Për t’i shpëtuar ndjekjeve të ushtarëve osman, Nikolla apo Kola Kota në mars të vitit 1877, u largua nga Korça qyteti i lindjes dhe u vendos në lagjen Kala në Berat, ku u strehua në shtëpinë e rënur të paraardhësve të tij, të larguar prej andej në vitin 1803. Në korrik të vitit 1877, Kol Kota me një “grup komitash” shkoi në Frashër dhe prej andej në Dangëlli, ku u takua me poetin dhe patriotin e madh Naim Frashëri. Atë ditë që mbëriti Kol Kota në Dangëlli, Abdyl Frashëri me të vëllanë Naimin, së bashku me bashkëfshatarët e tyre, krijuan “Lidhjen e Frashërit”. Kol Kota mori pjesë edhe në kuvendin ndërkrahinor të Frashërit, mbajtur në qershor të vitit 1880, si një ndër përfaqësuesit e krahinës së Korçës. Nikolla në pranverë të vitit 1888, u largua nga qyteti i Beratit me gruan dhe Llambin, djalin në moshën dhjetë vjeç dhe emigroi në Egjipt, në Aleksandri. Në këtë qytet kishte emigruar në vitin 1878, i jati Aleksandri, i cili i kishte shtuar të ardhurat nga aktiviteti tregëtar dhe ndihmonte emigrantët korçar që vinin për të punuar në Egjipt, apo të sëmurët që kishin nevojë për trajtime shëndetësore.

Nikollën e mundonte halli i Vatanit. Në muajin maj të vitit 1904, u largua nga Egjipti dhe shkoi në Sofje të Bullgarisë, ku ishte organizuar shoqëria atdhetare “Dëshira”. Atje u takua me shumë patriotë shqiptar dhe anëtarë të kësaj shoqërie. Në Sofje, informohet për përpjekjet e Bajo Topulli për ngritjen e komitave dhe të “Komitetit për Mbrojtjen e Kombit”. Bajo kishte ardhur nga Gjirokastra në Manastir dhe së bashku me Feim bej Zavalanin, Gjergj Qirjazin, Jashar Bitinckën, Nuçi Naçin, Riza bej Velçishtin, Grigor Cilkën, Qani bej Ypin dhe Sejfi Vllamasin, kishte krijuar “Komitetin e Manastirit”. Më pas, kishte shkuar në Korçë e Kolonjë ku kishte ngritur degë të reja. Qeveria turke e greke, u njoftuan për lëvizjen e shqiptarëve dhe

## Figura historike

# Nikoll Kota, patriot i çlirimit kombëtar

*Nikoll Kota, u kthye në simbol heroizmi e vetmohimi për pasardhësit e tij, në mbrojtje të çështjes shqiptare dhe të ruajtjes së pavarësisë së Shqipërisë*



filluan kërkimet për zbulimin e qendrës dhe programit të “Komitetit Shqiptar”. Më 12 shkurt ndodhi masakra e Negovanit, ku andartët grek dhe grekomanët therën Papa Kriso Negovanin, të parin prift shqiptar që kërkonte shkëputjen e kishës ortodokse shqiptare nga kisha greke.

### Në lëvizjen kombëtare shqiptare që kishte filluar

Pas kësaj ngjarje, më 23 mars 1906, Bajo Topulli së bashku me nxënësit e “Gjimnasios”, Qamil Panariti, Pertef be Rusi dhe Selim be Pojani, lanë Manastirin dhe shkuan në Kolonjë. Rrugës me ta, bashkohet Hysen bej Dishnica dhe në Kolonjë Qani be Starja, Ypi dhe të tjerë. Menjëherë Bajo me shokë zunë nga veprimi duke formuar “çeta komitësh”. Lëvizja kombëtare shqiptare sapo kishte filluar. Në fillim të prillit të vitit 1906 Fan Noli u largua nga Misiri dhe mbriti në Amerikë, ndërsa në fund të prillit Ismail Qemali nga Anglia mbëriti në Aleksandri për t’u takuar me emigrantët shqiptar të Misirit. Më 16 maj 1907, Çerçiz Topulli me çetën e tij mbëriti në Karaburun, për të organizuar luftën kundër ushtrive turke, sipas planeve të hartuara nga Ismail Qemali. Për t’i shërbyer më mirë çështjes kombëtare, më 8 mars 1908, Fan Noli dorëzohet prift dhe themeloi “Kishën Ortodokse Autoqefale Shqiptare”, të pavarur nga Patriarkana e Kostandinopojës. Ndërkohë, Bajo Topulli ndodhej në

shqipe. Në Manastir, nën kujdesin e Feim bej Zavalanit, po organizonin mbajtjen e një kuvendi mbarkombëtar për “Njësimin e Alfabetit të Gjuhës Shqipe”. Për realizimin e këtij kuvendi dhe mbarëvajtjen e tij, Feim Zavalani, që ishte kryetar i shoqërisë “Bashkimi” të Manastirit, kërkonte mendimin e intelektualëve, luftëtarëve dhe patriotëve. Lajmet e botuara nga gazetat e Korçës, të cilat futeshin edhe në Greqi, informonin lidhur me ngjarjet patriotike, sociale, ekonomike dhe kulturore. Në një artikull redaksional botuar në nëntor të vitit 1908, në prag të mbajtjes të Kongresit të Manastirit, përmendej djali i tij, Llambi Kota, i cili i shkruante Feim Zavalanit, që t’a anëtarësonte në atë shoqëri. Një numër më pas, Llambi Nikoll Kota i shkruante përsëri Feim Zavalanit se mbështeste njësimin e alfabetit të gjuhës shqipe dhe shkrimin e saj me gërma latine. Sipas këtyre dokumentave, Llambi Kota bashkëpunonte me Feim Zavalanin, i cili e vlerësonte dhe i kërkonte mendim lidhur me çështje tepër të rëndësishme me karakter kombëtar. “Kongresi i Manastirit” u mbajt në datat 14-22 nëntor të vitit 1908, dhe vendosi unanimisht “Njësimin e alfabetit të gjuhës shqipe dhe shkrimin e tij me shkronja latine”.

Patriotët korçar që kishin theme-luar “Klubin e Diturisë Shqip”, nxitën rininë korçare të formonin një shoqëri kulturore. Më 23 nëntor 1908 djemtë e qytetit, Kostaq Kosturi, Nuçi Lapi, Petraq Krastafillaku, Odhise Kota, Kristaq Furxhi, Gavril Pepo e të tjerë, formuan shoqërinë kulturore “Band e Lirisë”, e cila do merrej me çështjen kombëtare. Xhon turqit u trëmbën dhe iu kundërvunë lëvizjes kulturore e patriotike shqiptare, duke organizuar në korrik të vitit 1909, një kongres të dytë i quajtur “Kongresi Xhonturkist”.

Për të përballuar mësymjen anti-shqiptare të xhonturqve, kishës sllave e greke, populli shqiptar dërgoi delegat në atë Kongres, përfaqësuesit e tij më të ditur, të kulturuar dhe të vendosur në mbrojtje të vendimeve të marra në Kongresin e Manastirit. Delegat të Korçës u zgjodhën Hafës ali Korça, Hymer beu, Loni Logori dhe Llambi Nikoll Kota. Sipas shtypit të asaj kohe, pas përfundimit të “Kongresit të Dibrës” dhe dështimit të synimeve të xhonturqve për të kthyer germat arabe, delegatët erdhën në Korçë dhe u pritën si heronj nga populli që thëriste dhe i brohoriste... germat tona duam ne...

Për të qenë pjesëtar në mesin e korçar, Nikoll Kota largohet nga Sofja dhe mbërrin në qytetin e tij të lindjes, që vlonte nga patriotizma dhe dëshira për t’a parë mëmëdheun të mëvehtësuar. Bashkë me dirigjentin njohur korçar Viso Mborja dhe të tjerë nga shtresa shoqërore të ndryshme, Nikolla anëtarësohet në shoqërinë “Banda e Lirisë”,

duke kontribuar me mjete financiare aktivitetet e sajë kulturore, politike e patriotike. Ndërkohë vëllai i tij Av. Sotir Kota dhe djali xhaxhait av. Vasil Kota, nxisnin Parinë Vendore dhe Pleqësinë Kishtare kundër sundimit osman dhe i kërkonin qeverisë greke të mbështeste kërkesat e shqiptarëve për të krijuar shtetin e tyre.

### Kuvendet drejt mëvehtësisë

I tradhëtuar nga qeveria greke, Ismail Qemali për të lidhur urat e shembura me Turqinë, në qershor të vitit 1911 mbëriti në Cetinjë, te krerët e malësorëve shqiptar, të cilët të kërcënuar nga Shefqet Turgut Pasha ishin strehuar bashkë me familjet e tyre në Mal të Zi. Me nxitjen e Ismail Qemalit, Ded Gjon Lulit dhe Luigj Gurakuqit, delegatët e malësorëve u mblodhën në Greqe në një Kuvend Kombëtar dhe nënshkruan një “Memorandum” me kërkesa kombëtare, për një “Shqipëri me Katër Vilajete” dhe besnikëri ndaj Perandorisë Osmane. Kërkesat e shqiptarëve të hartuar me Memorandumin e Greqës, Kuvendin e Drashovicës, Kuvendin e Sinjës dhe Kuvendin e Capos, u refuzuan nga Porta e Lartë. Pas kësaj Ismail Qemali arriti në përfundimin “Mëvehtësim të Shqipërisë nëpërmjet kryengritjes mbarëpopullore”.

Më 15 korrik 1911, Çerçiz Topulli me Aleks Koçin e Myftarin, pas një takimi koka kokë me Ismail Qemalin, nga Stambolli vjen në Korçë për të forcuar “Komitetin e Korçës” dhe për të vepruar me çetën e tij në Gjirrokastër. Më 21 korrik, në Korçë erdhi një ushtri e madhe osmane që deklaroi shtet-rrethimin. Komanda osmane goditi Komitetin dhe burgosi 26 patriotë shqiptarë, ndër ta Themistokli Gërmenji e Dervish Haderi. Çetat e Qamil Panaritit dhe Spiro Ballkamenit u bashkuan në Frashër dhe iu afruan Korçës gjysëm ore larg, me qëllim që t’i binin burgut. Por gjatë natës u rrethuan nga ushtria osmane dhe në përpjekje për të dalë nga rrethimi u vranë Kristaq M. Furxhi, Nuçi Lapi, Pajazit Rehova, Kostaq Spiro Kosturi, Odhisea N. Kota e Tushi Krastafillaqi. Sipas kujtimeve të Mihal Gramenos, veteranëve të asaj lufte dhe shtypit të kohës, “Lufta mbajti tri ditë e tre netë duke u vrarë mjaft njerëz, midis të cilëve Vasil Trebicka, Riza be Biblishti, Nikoll (Kol) Kota, Xhemaliu, e të tjerë, që kryenin detyrën e “vetëdashësit” për mbrojtjen e Korçës nga kryengritësit grekoman”. Nikoll Kota, u kthye në simbol heroizmi e vetmohimi për pasardhësit e tij, në mbrojtje të çështjes shqiptare dhe të ruajtjes së pavarësisë së Shqipërisë.

### Nikoll Kota përkrah lëvizjen kombëtare

Nikoll Kota, ndiqte zhvillimet politike dhe patriotike nga Sofja dhe inkurajonte familjarët e tij të përkrahnin lëvizjen kombëtare të Ismail Qemalit, Bajo Topullit dhe Fan Nolit. Në Korçë avokat Vasil Kota me disa anëtarë të pleqësisë kishtare, dolën hapur në mbështetje të Fan Nolit dhe kishës autoqefale shqiptare dhe kërkuan ardhjen e Nolit në Korçë. Në Vlorë me porosi të Ismail Qemalit, Thanas Floqi, Sotir Peci, Nuçi Naçi, Spiro J. Koleka e Kadri Gjata, çelën shkollën shqipe “Muradie” dhe themeluan “Lidhjen Kombëtare” për përhapjen e gjuhës



**Q**endra e Personel Rekrutimit, do të rekrutojë kandidatë për të ndjekur studimet për Përgatitjen e Oficerit të Ri në Akademinë e Forcave të Armatosura, për vitin akademik 2020 -2021, për 60 (gjashtëdhjetë) të drejta studimi, sipas specialiteteve ku arsimi universitar i përafrohet si vijon: Personel (Fakulteti i Shkencave Sociale dhe Fakulteti Juridik), Ndërlidhje (Fakulteti i Inxhinierisë Elektronike), Logjistike (Fakulteti Ekonomik), Xhenio (Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit), Forcë Detare (Inxhinieri Navale), Pilot (Inxhinieri Mekanike), Mjekësi (Fakulteti i Mjekësisë), Sinoptikë (Inxhinieri Gjeoinformatik dhe Gjeografi), Këmbësori (Fakultetet e tjera) Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit pranë Qendrës së Personel Rekrutimit është deri në 17 korrik 2020. Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit pranë Qendrës së Personel Rekrutimit është shtyer deri në 28 gusht 2020.

#### Kriteret e pranimit të kandidatëve:

Të jetë shtetas shqiptar; të mos jetë dënuar nga gjykata për vepra penale; të mos jetë në ndjekje penale; të mos jetë në proces gjykim penal nga gjykata; të ketë figurë të pastër morale; të mos ketë probleme me deportimin; të mos ketë probleme me drogën dhe alkolin; të mos jetë person i dyshuar, i padëshirueshëm, i evidentuar dhe implikuar nga organet e zbatimit të ligjit për veprimtari të kundraligjshme apo kriminale; në momentin e titullimit oficer aktiv, nuk duhet të ketë mbushur moshën 27 vjeç (01 Gusht 2021). Përjashtim bëjnë vetëm shtetasit që do të titullohen oficer, të cilët do të jenë personel mjekësor i FA-së dhe që në momentin e titullimit nuk duhet të kenë mbushur moshën 32 vjeç (01 Gusht 2021); të kenë gjatësinë trupore mbi 170 për meshkujt dhe mbi 165 cm për femrat; të jetë shpallur fitues në përfundim të konkurimit; të jetë vlerësuar i aftë për të shërbyer në FA gjatë ekzaminimit mjekësor nga NJMU-ja e FA-së; të ketë rezultuar pa probleme gjatë verifikimit të kushtit të sigurisë të kryer nga strukturat përgjegjëse, të mos jetë bartës i virusit HIV, Hepatit B dhe SST (sëmundjeve seksualisht të transmetueshme), të mos vuajë ndërkohë nga sëmundje të tjera të zemrës, veshkave, hepatike, pulmonare, neuropsikiatrike, sistemit lokomotor (sistemit kockor dhe i lëvizjes) apo të jetë përdorues i lëndëve narkotike; të jenë në zotërim të diplomës së arsimit të lartë, (minimumi bechelior) brenda ose jashtë vendit, të njohur dhe të ekuivalentuar nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve të Republikës së Shqipërisë dhe të ketë notën mesatare të të gjitha viteve të arsimit të lartë, jomë pak se 6 (gjashtë); të mos jetë i larguar nga puna në administratën qendrore ose lokale (nëse ka qenë i



## Akademia e Forcave të Armatosura

# Viti akademik 2020-2021, aplikoni për 60 të drejta studimi

*Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit pranë Qendrës së Personel Rekrutimit shtyhet deri më 28 gusht 2020*



punësuar para aplikimit), për shkelje të dispozitave të kodit të punës ose legjislacionit në fuqi.

Kandidatët që rekrutohen nga rradhët e FA-së (nga rradhët e ushtarëve dhe nënoficerëve) përveç kriterëve të cituara më sipër duhet të kenë vlerësimin e fundit të punës jo më pak se “shumë mirë”; të mos kenë asnjë masë disiplinore në fuqi. Kandidati që nuk plotëson qoftë edhe një nga kriteret e përcaktuara, skualifikohet.

#### Procedurat e aplikimit:

Kërkesën për të marrë pjesë në konkurrim, kandidatët ia adresojnë pranë Qendrës së Personel-Rekrutimit. Kërkesa do të bëhet sipas modaliteteve të trajtuara në Aneksin A. Kandidatët që rekrutohen nga rradhët e ushtarëve/detarëve apo nënoficerëve aktivë, një kopje të kërkesës do t’ia drejtojnë komandës ku kryejnë shërbimin aktiv. Komandat brenda 5 ditësh nga marrja e kërkesës lëshojnë një rekomandimin për

pjesëmarrjen e kandidatit në konkurrim dhe cilësitë e tij.

#### Dokumentet për regjistrim:

Kandidatët që do të rekrutohen për ndjekjen e studimeve brenda vendit, duhet të paraqesin dokumentacionin e mëposhtëm: a) Në fazën e regjistrimit kërkesë me shkrim; formular me të dhëna personale sipas formatit të përcaktuar në aneksi A; fotokopje e kartës së identitetit; fotokopje e noterizuar e

dokumentit zyrtar (diplomës) që vërteton përfundimin e arsimimit të lartë së bashku me listën e notave të lëndëve; fotografi për dokument (4x6), 2 copë; formularët e vetëdeklarimit, të cilët plotësohen pranë QPR-së në momentin e dorëzimit të dokumentacionit; raport mjekësor të lëshuar nga mjeku i familjes i qendrës shëndetësore të vendbanimit. analizat e gjakut për hepatitin B dhe C, HIV/AIDS dhe grupin e gjakut të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut ose bangat e gjakut apo drejtoritë e Shëndetit Publik në rrethet ku banojnë. b) Në përfundim të testimit; Kandidatët që janë kualifikuar në testimet e zhvilluara, brenda 5 ditëve duhet të paraqesin dokumentacionin e mëposhtëm: dëshmi penaliteti; vërtetim nga gjykata; vërtetim nga prokuroria; vërtetim nga përmbartimi; raporti mjekësor i lëshuar nga komisioni mjeko-ligjor i Njësisë Mjekësore Ushtarake. Qendra e Personel Rekrutimit të sigurojë dokumentacionin, i cili mund të shkarkohet online nëpërmjet portalit qeveritar “e-albania”, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Kandidatët të sigurojnë vetë dokumentacionin e kërkuar në rastet kur për arsye teknike ai nuk mund të shkarkohet nëpërmjet portalit nga QPR-ja.

#### Datat e testimit:

Testi i Gjuhës së Huaj në gjuhën anglisht do zhvillohet 01.09.2020, Testi Fizik do të zhvillohet në datë 02.09.2020, Testi Intelektual zhvillohet në datë 03.09.2020 kurse Testi Psikologjik do të zhvillohet në datë 04.09.2020.



TURQIA DHE GREQIA JANË DY ALEATË TË RËNDËSISHËM TË NATO-s

# Stoltenberg: Ne jemi të shqetësuar për situatën në Mesdheun lindor

*Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s diskuton Bjellorusinë, Mesdheun Lindor me ministrat e mbrojtjes të BE-së*

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, më 26 dhe 27 gusht 2020, mori pjesë në një takim informal të ministrave të Mbrojtjes të Bashkimit Evropian në Berlin, për të diskutuar lidhur me misionet dhe operacionet, situatën në Bjellorusi, si dhe situatën në Mesdheun Lindor. Në kufijtë e takimit, Z. Stoltenberg zhvilloi takime dypalëshe me ministrat dhe Përfaqësuesin e Lartë të BE/ Zëvendës Presidentin e Komisionit Evropian Josep Borrell, kurse të enjten, 27 gusht 2020, Stoltenberg u takua me kancelaren gjermane Angela Merkel, me të cilën dolën edhe para shtypit me një deklaratë të përbashkët. Sekretari i Përgjithshëm zhvilloi gjithashtu takime me zyrtarë të tjerë të lartë.

## NATO e shqetësuar për situatën në Mesdheun Lindor

Në deklaratën e tij Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg përpara takimit joformal me ministrat e Mbrojtjes së BE-së tha se “Është mirë të kthehemi në Berlin dhe është mirë që gjithashtu të kemi këtë mundësi të takohemi me ministrat e Mbrojtjes së BE-së. Unë mendoj se fakti që Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s merr pjesë në takimin Ministror të Mbrojtjes të BE-së tregon bashkëpunimin e ngushtë midis NATO-s dhe Bashkimit Evropian.

Ne do të trajtojmë misionet dhe operacionet. Unë do të azhurnoj ministrat mbi pranimin e NATO-s në Afganistan. Ne qëndrojmë të përkushtuar për pranimin tonë atje sepse besojmë se kjo është mënyra më e mirë për të mbështetur përpjekjet e paqes dhe shohim një përparim inkurajues, kur bëhet fjalë për të ecur drejt fillimit të dialogut ndër-Afganistan, negociatat ndër-afgane për të krijuar një zgjidhje të qëndrueshme dhe paqësore të krizës në Afganistan.

Unë gjithashtu do të azhurnoj ministrat për punën e NATO-s se si të rritim pranimin tonë në Irak. Trajnimi i forcave lokale, trajnimi i forcave irakiane të sigurisë, ndërtimi i kapaciteteve lokale është mënyra më e mirë për të parandaluar që ISIS të jetë në gjendje të kthehet, dhe si në Afganistan ashtu edhe në Irak, NATO dhe Bashkimi Evropian janë duke punuar shumë ngushtë së bashku, dhe ne tani jemi duke rritur përpjekjet në Irak.

Atëherë, sigurisht që ne po ndjekim nga afër krizën në Bjellorusi. Ajo evoluon në kufijtë tanë. Populli i Bjellorusisë duhet të ketë të drejtë të vendosë të ardhmen e tij. Të gjithë aleatët respektojnë sovranitetin, integritetin, pavarësinë e Bjellorusisë dhe NATO mbetet



një Aleancë mbrojtëse. Ne jemi vigjilentë, jemi gati të mbrojmë dhe sigurojmë të gjithë aleatët. Por nuk ka asnjë vendosje ushtarake të NATO-s në rajon. Pra, çdo përpjekje e regjimit të ndërtuar në Bjellorusi, për ta përdorur NATO-n si justifikim ose si pretekst për të goditur demonstruesit në vendin e tyre është absolutisht e gabuar, është absolutisht e pajustificuar.

Ne jemi të shqetësuar për situatën në Mesdheun lindor. Ajo që na duhet është de-përshkallëzimi, është dialogu. Turqia dhe Greqia kanë qenë të dy Aleatët e rëndësishëm të NATO-s për shumë vite. Dhe ne kemi nevojë për të gjetur një mënyrë për të zgjidhur situatën në Mesdheun Lindor, bazuar në

frymën e solidaritetit aleat dhe të drejtës ndërkombëtare, dhe unë mirëpres përpjekjet e Gjermanisë për të ndërmjetësuar për të gjetur një rrugë përpara. Dhe unë gjithashtu jam personalisht në kontakt rregullisht me Ankarën dhe Athinën. Unë fola kohët e fundit me kryeministrin grek Mitsotakis. Ne vazhdojmë të sigurojmë NATO-n si një platformë që Aleatët të takohen dhe diskutojnë se si të gjejnë zgjidhjen për këtë situatë në Mesdheun lindor.

Lidhur me Operacionin Sophia në Mesdhe, Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Stoltenberg tha se “NATO i dha mbështetje misionit të mëparshëm të BE-së në Mesdhe, Operacionit Sophia. Tani ne po shohim se si mund të punojmë së bashku me

misionin e BE-së, por nuk ka asgjë të re në lidhje me këtë sot”.

## NATO nuk ka asnjë vendosje ushtarake në rajonin Bjellorusi

Kurse lidhur me protestat në rritje në Bjellorusi, ndikimin e mundshëm të Rusisë, apo atentatin e mundshëm të drejtuesit të opozitës ruse, Alexei Navalny, Sekretari i Përgjithshëm tha se “Ne jemi shumë të shqetësuar për situatën në Bjellorusi. Ne kemi parë sesi regjimi, si qeveria ka përdorur dhunën kundër demonstruesve paqësorë. Ne u bëjmë thirrje atyre, regjimit, Presidentit, të respektojnë vlerat themelore, të drejtat themelore, duke përfshirë lirinë e fjalës, duke

përfshirë të drejtën për demonstrime paqësore, të cilat janë pjesë e çdo shoqërie demokratike dhe të cilat janë të drejta themelore”, tha Stoltenberg. Natyrisht tha ai që NATO po ndjek shumë nga afër këto zhvillime, pasi “ato evoluojnë në kufijtë tanë”. Ai tha se “është plotësisht e qartë nga të gjithë aleatët e NATO-s se njerëzit në Bjellorusi, ata, kanë të drejtë të vendosin të ardhmen e tyre pa ndërhyrje nga jashtë, ndërhyrje nga Rusia dhe natyrisht, kanë të drejtë të kenë zgjedhje të lira dhe të ndershme. Ne shohim përpjekje për të përdorur NATO-n si një lloj justifikimi për goditjen e demonstruesve, për kundërshtimin politik në Bjellorusi, gjë që është absolutisht e gabuar, sepse nuk ka vendosje ushtarake nga NATO në rajon dhe çdo përpjekje e regjimit në Minsk, në Bjellorusi, të përpjeksh të zhvendosësh përqendrimin nga çështjet e brendshme në çështjet e jashtme, të krijojnë një justifikim për përdorimin e dhunës ndaj njerëzve të tyre, nuk është e pranueshme dhe është e gabuar dhe është e pajustificuar”, nënvizoi Stoltenberg.

“Kur bëhet fjalë për Alexei Navalny, sigurisht që jemi të shqetësuar për shëndetin e tij. I uroj një shërim të shpejtë. Ne i mirëpresim përpjekjet e Gjermanisë për ta ndihmuar atë dhe spitalit këtu në Gjermani që ofron kujdesin mjekësor tani për të. Ne nuk kemi pse të dyshojmë në gjetjen e mjekëve në spital. Dhe ajo që na duhet tani është një hetim transparent për të zbuluar se çfarë ndodhi dhe për t'u siguruar që ata që janë përgjegjës të jenë përgjegjës”.





## ANGAZHIM I SHTETEVE TË BASHKUARA PËR NATO-N

# Gjashtë avionë bombardues amerikanë B-52 mbërrijnë në Evropë

*Vendosja e planifikuar për një kohë të gjatë do të përfshijë trajnime fluturimi me aleatët dhe partnerët e NATO-s në ditët e ardhshme*

**G**jashtë avionë bombardues të Forcës Ajrore B-52 të Stratofortress nga 5-të Bomb Wing, Baza e Forcës Ajrore Minot në Dakotën e Veriut, mbërritën në Royal Air Force Fairford, në Mbretërinë e Bashkuar të shtunën (22 gusht 2020). Vendosja e planifikuar për një kohë të gjatë do të përfshijë trajnime fluturimi me aleatët dhe partnerët e NATO-s në ditët e ardhshme.

Zëdhënësja e NATO-s, Oana Lungescu përhëndeti ardhjen, duke thënë: “Kjo vendosje është një shenjë e fortë e angazhimit të qëndrueshëm të Shteteve të Bashkuara për NATO-n dhe sigurinë evropiane. Avionët amerikanë do të fluturojnë përkrah forcave ajrore aleate në ditët në vijim, duke nderuar aftësinë tonë për të

punuar së bashku në përgjigje të çdo sfide. NATO është një aleancë mbrojtëse dhe për më shumë se shtatëdhjetë vjet kombet tona kanë qëndruar së bashku për të penguar agresionin, për të parandaluar konfliktin dhe për të ruajtur paqen.”

Që nga viti 2018, SHBA ka realizuar më shumë se 200 lloje Task Force Bombardueshish me aleatët dhe partnerët. Kohët e fundit, kjo përfshinte

fluturime B-1B Lancer mbi rajonet Nordike, Balltike dhe Detit të Zi në maj, si dhe një fluturim të policisë ajrore të Maqedonisë Veriore, anëtarit më i ri i NATO-s. Në qershor, B-52H Stratofortresses zhvilloi fluturime mbi Oqeanin Arktik, dhe më vonë mori pjesë në BALTOPS, stërvitja më e madhe vjetore në Detin Baltik, e cila mbledhi 3,000 personel nga 19 aleatët dhe partnerët e NATO-s.



## AVIONI AWACS I NATO-S MBRIN NË POLONI

# Trajnime një-javor me forcat ajrore polake dhe amerikane

**N**jë avion i NATO-s, AWACS, mbërriti në Krakow, Poloni të premten (21 gusht 2020) për një aktivitet trajnime një-javor me forcat ajrore polake dhe amerikane. Aktiviteti i planifikuar që më parë përfshin ushtrimin e komandës ajrore dhe kontrollit mbi territorin aleat. Bazuar në bazën ajrore Geilenkirchen në Gjermani, flota e NATO-s prej 14 avionësh AWACS kryen një gamë të gjerë operacionesh – përfshirë fluturime në mbështetje të Koalicionit Global për të mposhtur ISIS-in, si dhe Operacionin Sea Guardian. Nga 21 deri në 28 gusht 2020 aeroplani AWACS, i NATO-s, i vendosur në Krakow, Poloni i bashkohet në trainimin binacional aleatëve, Polonisë dhe Shteteve të Bashkuara. Duke punuar ngushtë së bashku me Qendrën Polake të Kontrollit dhe Raportimit, ekuipazhi AWACS do të mbështesë aeroplanin luftarak Polak dhe SHBA duke siguruar komandë dhe kontroll ajror. Përfshirja e AWACS në stërvitjen “Aviation Detachment Rotation 20-4”, është një aktivitet i



planifikuar prej një kohe të herëshme, që përfshin fluturime mbi territorin e aleatëve. Isshtë pjesë dhe e mandatur nën Masat e Sigurimit të NATO-s, të zbatuara në vitin 2014 pas aneksimit të paligjshëm dhe ilegal të Krimesë nga Rusia. Këto masa janë krijuar për të siguruar anëtarët lindorë të Aleancës për angazhimin dhe solidaritetin e NATO-s, si dhe për të parandaluar çdo agresion të mundshëm kundër anëtarëve të NATO-s. Bazuar në bazën ajrore

Geilenkirchen në Gjermani, flota e NATO-s prej 14 avionësh AWACS kryen një gamë të gjerë operacionesh – përfshirë fluturime në mbështetje të Koalicionit Global për të mposhtur ISIS-in, si dhe Operacionin ‘Sea Guardian’. Ata rregullisht kryejnë fluturime nën Masat e Sigurimit të NATO-s në të gjithë zonën e zbatimit, duke përfshirë fluturime të mbikqyrjes ajrore, mbështetje të ushtrimeve ose “shfaqje të pranisë”, siç janë fluturimet.

## Gjashtë avionë kanadezë CF-188 do kryejnë policimin ajror

**D**uke filluar nga muaji shtator, një personel prej 145 ushtarakesh të Forcave të Armatosura Kanadeze dhe gjashtë avionë luftarakë kanadezë CF-188 Hornet do të kryejnë Policimin Ajror të zgjeruar të NATO-s në Rumani, së bashku me Forcën Ajrore Rumune F-16 Fighting Falcon dhe MiG-21 LanceR luftëtarët.

Për të pestën herë që nga viti 2014, një Task Forcë Ajrore Kanadeze do të vendoset në Rumani dhe do të operojë nga Baza Ajrore e Mihail Kogalniceanu pranë Kostandinës, nën Masat e Sigurimit të NATO-s në Jug.

Shkëputja e specialistëve nga e gjithë Forcat e Armatosura Kanadeze do të udhëhiqet nga nënkoloneli David McLeod. Përveç trainimit të kombinuar me Forcën Ajrore Rumune dhe Aleatët e tjerë në rajon, ekipi i tij do të punësohet gjithashtu për të fluturuar misionet e Policisë Ajrore të NATO-s në brigjet e Detit të Zi të kontrolluar nga Qendra e Operacioneve Ajrore të Kombinuara në Torrejón, Spanjë.

Prania kanadeze në Rumani tregon kohezionin e NATO-s dhe vendosmërinë kolektive të Aleatëve për të zbatuar frenimin dhe mbrojtjen. Mbështetja e vazhdueshme e Kanadasë me vendosjen e tyre në Evropë nënvizon lidhjen transatlantike.

## NATO: Operacion historik në ujërat e Norvegjisë Veriore

**G**rupi i Parë i Qëndrueshëm Detar i Masave Kundër Minave, i NATO-s (SNMCMG 1) ka përfunduar një operacion historik të largimit të depozitimeve përgjatë bregdetit verior të Norvegjisë, në zonat në Lofoten dhe Tromsø, duke i bërë ato më të sigurta për peshkatarët, transportin tregtar, operacionet nënujore dhe instalimet civile.

Operacioni, i kryer midis 4 dhe 12 gushtit 2020, identifikoi dhe asgjësoi disa mina nga Lufta e Dytë Botërore. Aktivitetet e deponimit u zhvilluan në mënyrë që të ruanin sa më mirë ekosistemin detar. Operacioni ndihmoi në rritjen e njohurive për detin dhe kontribuoi në bazën e të dhënave të përpiluar historike norvegjeze për artikuljt.


Gjatë operacionit u identifikuan tetë mina historike, midis 147 objekteve të ngjashme me minat. Dy gjuajtës të minave dhe flamuri i tre kombeve të ndryshme u përfshinë në operacion, duke kërkuar në një sipërfaqe prej 16 milje katrore detare dhe disponimin e tre minave historike nga operacionet e mëparshme, duke marrë të gjitha masat paraprake për të ruajtur jetën e detit.

Gjatë Luftës së Dytë Botërore, forcat aleate vunë mina nga brigjet e Norvegjisë nga anije sipërfaqësore, nëndetëse dhe avionë me qëllim të shqetësimit dhe ndalimit të konvojeve gjermane, transportit të trupave dhe anije luftarake përgjatë bregdetit.

Duke asgjësuar minat e detit, Grupi e bëri detin një vend më të sigurt për peshkatarët, transportin tregtar, operacionet nënujore dhe instalimet civile. Megjithatë minierat nuk ishin më aktive, ato ende paraqesnin një kërcënim nëse kishin kontakt me një spirancë, zhytës ose operacione të tjera në det.

SNMCMG1 është një nga katër forcat e qëndrueshme të NATO-s që përbëjnë përbërësin detar të Task Forcës së përbashkët të gatishmërisë shumë të lartë (VJTF), e cila është pjesë e Forcës së Reagimit të NATO-s (NRF). SNMCMG1 aktualisht përbëhet nga katër anije: HNoMS Maaløey (Norvegji), Admiral Cowan (Estoni) ENS, FGS Groemitz (Gjermani) dhe flagship LNS Jotvingis LNS Jotvingis (Lituani).





“Bashkëpunimi ndërinstitucional për ta luftuar pandeminë po i jep rezultatet e veta. Në momente të vështira kemi pranë djemtë dhe vajzat e FSK-së, që janë të gatshëm për t'u vënë plotësisht në shërbim të qytetarëve”, -tha ministri Zemaj.



## BASHKËPUNIMI NDËRINSTITUCIONAL PËR TA LUFTUAR PANDEMINË

# FSK: Ekipi mjekësor i bashkohet stafit mjekësor të QKUK-së

Pas trajnimit specifik për përballje me pandeminë COVID-19, stafi mjekësor i Qendrës Klinike Universitare të Kosovës, iu bashkuan tri ekipe mjekësore në përbërje prej 12 infermierë/re nga Forca e Sigurisë së Kosovës. Ky kontingjent profesional i FSK-së do të shërbejë në kuadër të sistemit manaxherial të QKUK-së dhe do të lehtësojë shumë stafin permanent të Klinikës Infektive pas angazhimit të sforcuar të tyre dhe nevojës imediate për staf shtesë përgjatë periudhës së shfaqjes së pandemisë në vendin tonë. Të pranishëm në ceremoninë e fillimit të angazhimit të ekipeve mjekësore të FSK-së, përveç drejtorit të QMFSK-së, Dr. Shkëlzen Syla, ishin edhe ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj dhe u.d. drejtori i përgjithshëm i SHSKUK-së, Dr. Valbon Krasniqi. Nga ana e tij, dr. Krasniqi, vlerësoi lart mbështetjen e ofruar në këtë formë nga ana e FSK-së, duke shprehur besimin e plotë në shkathtësitë dhe profesionalizmin e dëshmuar në të gjitha aktivitetet dhe ndihmën konkrete tani ndaj pandemisë COVID-19.

“Kam shumë besim në profesionalizmin tuaj. Shkëmbimi i përvojave tuaja do ta ndryshojë mozaikun e plotë për shërbime sa më kualitative për pacientët tanë”, - ka deklaruar Krasniqi. Nga ana



e tij, ministri Zemaj, theksoi se përmes këtij bashkëpunimi do të fuqizohet lufta kundër pandemisë COVID-19. “Bashkëpunimi ndërinstitucional për ta luftuar pandeminë po i jep rezultatet e veta. Në momente të vështira kemi pranë djemtë dhe vajzat e FSK-së, që janë të gatshëm për t'u vënë plotësisht në shërbim të qytetarëve”, -tha ndër të tjera ministri Zemaj. Sipas drejtorit të Qendrës Mjekësore të FSK-së, Dr. Shkëlzen Syla, ekipe të ngjashme mjekësore të FSK-së janë duke u përgatitur për mbështetjen edhe të qendrave spitalore rajonale të vendit. Që nga marsi kur janë paraqitur rastet e para me COVID-19, FSK në kuadër të detyrës së saj ligjore për mbështetjen ushtarake të autoriteteve civile, ka ngritur gjendjen e gatishmërisë në nivelin 2 dhe ka realizuar aktivitete të shumta me aftësitë dhe kapacitetet e saj operacionale në dispozicion.

RREGULLORE

## “Organizimi dhe shërbimi mjekësor në FSK”

*Rregullorja “Per Organizimin dhe shërbimi mjekësor në Forcën e Sigurisë së Kosovës” është firmosur nga ministri i Mbrotjes, z.Anton Quni, më 10 korrik 2020*

Ministri i Mbrotjes i Republikës së Kosovës, z.Anton Quni ka firmosur me 10 korrik 2020, rregullohen “Per Organizimin dhe shërbimi mjekësor në FSK” e cila për qëllim organizimin e shërbimeve mjekësore në FSK, përcaktimin e rregullave dhe procedurave për ofrimin e shërbimeve mjekësore dhe përkujdesjen shëndetësore për personelin e Ministrisë së Mbrotjes, pjesëtarët e FSK-së, si dhe për anëtarët e ngushtë të familjes së pjesëtarit, përderisa ai/ ajo gjendet në mision jashtë vendit. Kjo rregullore zbatohet ndaj të gjithë personelit të MM-së, personelit të FSK-së, si dhe ndaj anëtarëve të ngushtë të familjes së pjesëtarit, përderisa ai/ajo gjendet në mision jashtë vendit.

### Struktura organizative mjekësore

Ja struktura organizative mjekësore në MM dhe FSK: Departamenti Mjekësor në MM; Zyra për Çështje Mjekësore në SHPFSK; Regjimenti i Mjekësisë; dhe Qendra Mjekësore e FSK-së. Departamenti Mjekësor ka për detyrë që të hartojë dhe të monitorojë politikat dhe planet për kujdesin shëndetësor, të marrë pjesë në negociimin e memorandumëve/ marrëveshjeve me institucionet mjekësore brenda dhe jashtë vendit, si dhe detyra të tjera të përcaktuara me rregulloren (QRK) përkatëse për Organizimin e Brendshëm dhe Siste-

matizimin e Vendeve të punës në Ministrinë e Mbrotjes, si dhe detyra të tjera bazuar në ligjet përkatëse në fuqi. Zyra për Çështje Mjekësore zbërthen politikat mjekësore në plane, përgatitë udhëzimet për realizimin e shërbimit mjekësor në FSK dhe planifikon zhvillimin dhe modernizimin e sistemit mjekësor në FSK. Regjimenti i Mjekësisë është përgjegjës për ofrimin e shërbimeve mjekësore për të gjithë pjesëtarët e FSK-së, mjekësi parandaluese, dhe të mbështetës forcën në operacione si brenda dhe jashtë vendit. Qendra Mjekësore e Forcës ka për detyrë të ofrojë shërbime mjekësore specialiste, diagnostike, si dhe ekzaminimin sistematik mjekësor.

### Shërbimet mjekësore

Shërbimet mjekësore konsistojnë në: ruajtjen e shëndetit dhe parandalimin e sëmundjeve; trajtimin e të sëmurëve dhe të lënduarve; evakuimin e të sëmurëve dhe të lënduarve; regjistrimin dhe raportimin mjekësor; furnizimin me material mjekësor; bashkërendimin e resurseve njerëzore dhe rajnimit e personelit mjekësor dhe jomjekësor.

### Ofrimi i shërbimeve mjekësore

Forca e Sigurisë së Kosovës, aty ku është e mundshme, brenda burimeve të veta, ofron shërbime dhe kujdes shëndetësor për të gjithë personelin e saj dhe personelin e MM-së. FSK-ja ofron shërbime dhe kujdes shëndetësor për anëtarët e ngushtë të familjes së pjesëtarit, përderisa ai/ajo gjendet në mision jashtë vendit. Në rastet kur shërbimet nuk janë të mundshme, ose kur kërkesa është jashtë fushës të cilën e mbulon shërbimi mjekësor i FSK-së, pjesëtarët duhet të dërgohen në sistemin e kujdesit shëndetësor kombëtar. Kur kujdesi shëndetësor kombëtar nuk ofron shërbimin përkatës mjekësor, trajtimi mjekësor i pjesëtarit të FSK-së dhe personelit të MM-së bëhet jashtë vendit, mbi bazën e marrëveshjeve të bashkëpunimit që ka MM. Në rastet kur shërbimet përkatëse shëndetësore nuk mbulohen as me marrëveshje bashkëpunimi, pjesëtarët e FSK-së dërgohen për shërim në institucionet e specializuara brenda dhe jashtë vendit, përmes programeve të Ministrisë së Shëndetësisë. Për zbatim të paragrafëve e këtij neni, është përgjegjës Bordi i veçantë Mjekësor, i caktuar nga ministri i Mbrotjes, përbërë nga 3 anëtarë dhe

kryesohet nga Drejtori i Departamentit të Mjekësisë në MM. Dy anëtarë të tjerë janë nga fusha e mjekësisë së FSK-së që rekomandohen nga KOMFSK. Për ekzekutimin e vendimeve të Bordit zbatohen procedurat administrative sipas rregullave në fuqi.

### Kontrolli i obliguar mjekësor

Ekzaminimet e detyrueshme mjekësore për pjesëtarët e FSK-së bazuar në kriterin e moshës janë: Nga moshja 18 deri 30 vjeçare çdo 3 vite; Nga moshja 31 deri 40 vjeçare çdo 2 vite; Nga moshja 41 e lart çdo 1 vit. Pjesëtarët e FSK-së janë të obliguar t'i nënshtrohen kontrollit të rregullt dhe të planifikuar mjekësor, në përmbushje të standardeve për mbajtjen e gjendjes së kërkuar mjekësore për shërbim në FSK. Kontrollat e obligueshme mjekësore për pjesëtarët e FSK-së bëhen edhe në rastet si: Para dërgimit në arsimim/shkollim në rast se kërkohet nga shteti ofrues; Para dërgimit dhe pas kthimit nga misioni jashtë vendit. Kontrolli i detyrueshëm mjekësor bëhet menjëherë pas kthimit nga misioni jashtë vendit. Në raste specifike, në çdo kohë, sipas urdhrat të KOMFSK-së bëhet ekzaminimi i

përgjithshëm mjekësor për pjesëtarët e FSK-së. Raportet e kontroleve mjekësore sipas këtij neni, i dërgohen Bordit Mjekësor të FSK-së.


### Librezat dhe dosjet mjekësore

Pjesëtar i FSK-së duhet të pajiset me librezë shëndetësore dhe me librezë të vaksinimit. Dosja mjekësore e pjesëtarit të FSK-së ruhet një kopje në njësi dhe një kopje në Regjimentin Mjekësor. Raporti përfundimtar i pjesëtarit i lëshuar nga Bordi Mjekësor i FSK-së, dorëzohet në dosjen e personelit dhe me të njëjtin njoftohet edhe pjesëtar.

### Kujdesi shëndetësor për familjen e pjesëtarit

FSK-ja ofron kujdes shëndetësor për anëtarët e ngushtë të familjes së pjesëtarit të FSK-së, përderisa ai/ajo gjendet në mision jashtë vendit. Familjarit të pjesëtarit të FSK-së i cili gjendet jashtë vendit, të drejtat e kujdesit shëndetësor i takojnë siç janë të përcaktuara në paragrafët e kësaj rregulloreje. Procedurat e realizimit të këtyre të drejtave do të jenë të njëjtat të caktuara me këtë rregullore.





Presidenti Pendarovski theksoi se Maqedonia e Veriut do të vazhdojë t'i përforcojë marrëdhëniet me Holandën dhe në këtë drejtim e falënderoi për mbështetjen shumëvjeçare të hapur për të ndihmuar shoqërinë maqedonase në reformat e nevojshme për përmbyllje të suksesshme të anëtarësimit në NATO dhe për negociatat për anëtarësim në BE.



Shefi i Ushtrisë Holandeze, admiral Robert Bauer, në Shkup

# Anëtarësimi në NATO, shanse bashkëpunimi ushtarak me Holandën

*Presidenti i Maqedonisë së Veriut, njëkohësisht komandant i Përgjithshëm i Armatës Maqedonase, Stevo Pendarovski, priti Shefin e Ushtrisë Holandeze, admiralin Robert Bauer*

Presidenti i Maqedonisë së Veriut, njëkohësisht komandant i Përgjithshëm i Armatës Maqedonase, Stevo Pendarovski, me datë 21 gusht 2020, pasdite në Vilën Biljana në Ohër ka pritur Shefin e Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Mbretërisë së Holandës, admiralin Robert Bauer, i cili është në vizitë zyrtare në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Në këtë takim u bisedua mbi proceset e transformimit të Armatës së Republikës së Maqedonisë së Veriut, pjesëmarrjen në operacionet dhe ushtrimet, si dhe mbi kontributin e saj në ballafaqimin me pandeminë e shkaktuar nga virusi korona dhe

krizën e migrantëve.

Bashkëbiseduesit shkëmbyen mendime mbi bashkëpunimin midis Maqedonisë së Veriut dhe Holandës, ku u konstatua se anëtarësimi në NATO hap mundësi të reja për intensifikimin e bashkëpunimit ushtarak dhe mbrojtës midis të dy shteteve.

Presidenti Pendarovski theksoi se

Maqedonia e Veriut do të vazhdojë t'i përforcojë marrëdhëniet me Holandën dhe në këtë drejtim e falënderoi për mbështetjen shumëvjeçare të hapur për të ndihmuar shoqërinë maqedonase në reformat e nevojshme për përmbyllje të suksesshme të anëtarësimit në NATO dhe për negociatat për anëtarësim në BE.

Gjenerallejtënant Vasko Gjurginovski-Admirali Robert Bauer

## Bashkëpunim operacional dhe stërvitje të përbashkëta me holandezët

Shefi i Forcave të Armatosura (AF) i Mbretërisë së Holandës, Admirali Robert Bauer, i cili bëri një vizitë zyrtare tre ditore në Republikën e Maqedonisë Veriore, u takua në Shtabin e Përgjithshëm të Ushtrisë dhe Ministrinë e Mbrojtjes, me Shefin e Shtabit të Përgjithshëm, gjenerallejtënant Vasko Gjurginovski dhe Ministren e Mbrojtjes Radmila Sekerinska.

Gjeneral Gjurginovski, pasi shprehu mirënjohje për mbështetjen e vazhdueshme dhe kontributin e Asamblesë së Përgjithshme të Mbretërisë së Holandës për anëtarësimin tonë të plotë në NATO, diskutoi me homologun e tij mundësitë e përpimit të bashkëpunimit të ardhshëm si aleatë të NATO-s, veçanërisht në procesin e edukimit ushtarak dhe bashkëpunimit operacional duke kryer ushtrime të përbashkëta ushtarake duke përdorur objektet e Zonës së Stërvitjes së Ushtrisë Krivolak. Admirali Bauer shprehu gatishmërinë për të intensifikuar bashkëpunimin e mëtejshëm dhe ndihmën e ekspertëve në procesin e integritetit të plotë në strukturat e NATO-s. Gjatë takimit të ministres Sekerinska me Admirali Bauer, u diskutuan gjithashtu mundësitë e përpimit të bashkëpunimit dypalësh dhe sfidat e reja në mbrojtje. Ushtria e Republikës së Maqedonisë Veriore ka zhvilluar bashkëpunim ushtarak me Forcat e Armatosura të Mbretërisë së Holandës që nga viti 1999.



## Akademia "Mihailo Apostolski" do hapë dyert për 25 studentë

Akademia Ushtarake "Gjeneral Mihailo Apostolski" Shkup ka shpallur konkursin për regjistrimin e studentëve/kadetëve për nevojat e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Armatës së Republikës së Maqedonisë së Veriut në ciklin e parë të studimeve në Akademinë Ushtarake për 25 kandidatë. Studimet e ciklit të parë të studimeve organizohen sipas programeve studimore të akredituara me ligj, normativa, standarde dhe metodologji të pranuar nga hapësira e vetme evropiane për arsim të lartë, të vlerësuara me kredi sipas ECTS-së. Programet studimore të ciklit të parë të studimeve në akademi përmbajnë 240 kredi dhe zgjasin katër vite. Çdo vit në programin studimor përmban 60 kredi.

Të drejtë pjesëmarrjeje në konkurs kanë kandidatët të cilët i plotësojnë kushtet e përgjithshme: të jenë shtetas të Republikës së Maqedonisë së Veriut; të kenë të mbaruar arsim të mesëm katërvjeçar; mos të jenë më të moshuar se 21 vjeç në ditën e aplikimit dhe dorëzimit të doku-

menteve dhe të jenë të aftë psikofizikisht (vërtetohet përmes komisionit ushtarako-mjekësor). Krahas kushteve të përgjithshme, kandidatët duhet të përmbushin edhe kushtet e veçanta: të mos të kenë marrë masë ndaluese për kryerje të profesionit, aktivitetit apo detyrës; të plotësojnë kriteret e sigurisë sipas Ligjit për Informata të Klasifikuara, që i vërteton shërbimi përkatës në Ministrinë e Mbrojtjes me sukses të kenë kaluar testin për aftësi fizike me Test-program për kontrollimin e aftësive motorike të studentëve/kadetëve dhe të studentëve të programeve të akredituara studimore në ciklin e parë të studimeve në Akademi. Kandidatët e interesuar për pranim në Akademinë Ushtarake për vitin akademik 2020/2021 mund të aplikojnë në Akademinë ushtarake në Shkup në rr."Vasko Karangeleski" në afatin e

parë regjistruar në ditët 5, 6, dhe 7 gusht 2020, prej orës 8,30 deri në ora 16,30. Nëse në afatin e parë pranues nuk plotësohet numri i planifikuar i kandidatëve, Akademia Ushtarake do të organizojë një afat të dytë regjistrimi më datë 4 shtator 2020, në periudhë prej orës 8:30 deri 16:30 dhe nëse nuk pranohen kandidatët në numrin e planifikuar, Akademia ushtarake do të organizojë edhe afat të tretë regjistruar më datë 18 shtator 2020, në periudhë prej orës 8:30 deri 16:30. Pas përcaktimit të listave për paraqitje, kandidatët të cilët i plotësojnë kushtet e konkursit do të thirren për të testuar aftësitë psikofizike dhe gjendjen fizike dhe për dhënien e provimeve pranuese për matematikë dhe gjuhë angleze.


Kandidatët shtetas të Republikës së Maqedonisë së Veriut që arsimin e mesëm apo një pjesë të arsimit të mesëm e kanë përfunduar jashtë

vendit duhet të dorëzojnë dokument të lëshuar nga Ministria kompetente për nostrifikim të dëftësive për të gjitha vitet, për pjesën e viteve të mbaruara jashtë shtetit ose për diplomën e arsimit të mesëm të marrë jashtë vendit. Dokumentet për aplikim në konkurs kandidatët duhet t'i dorëzojnë personalisht në Akademinë Ushtarake në Shkup, rr."Vasko Karangeleski". Kandidatët është i obliguar që të gjitha dokumentet e lartpërmendura në origjinal ti parashtrijë deri te Akademia ushtarake gjatë kohës së realizimit të kontrolleve/provimeve me shkrim në Akademinë ushtarake. Afati përfundimtar për parashtrimin e dokumentacionit origjinal është realizimi i kontrollit të përgatshmërisë fizike, që është kontrolli i fundit e cila do të realizohet me kandidatën, para publikimit të listës pre eliminuar.

Kandidatët të cilët janë paraqitur në

ciklin e parë të studimeve për nevojat e Ministrisë së Mbrojtjes, gjegjësisht të Armatës së Republikës së Maqedonisë së Veriut pas përfundimit të studimeve marrin statusin studentë/kadetë. Gjatë kohës së shkollimit studentëve/kadetëve u sigurohen: akomodim në internate, ushqim, uniforma, veshje të brendshme dhe mbathje, tekste shkollore dhe mjete të tjera si dhe pajisje ndihmëse të nevojshme për studime, pa kompensim, sigurim shëndetësor dhe invalidor, pagesa mujore për të mbuluar nevojat personale më elementare, shpenzime të rrugës për ardhje në Akademi dhe kthim në fillim dhe mbarim të çdo viti shkollor dhe gjatë pushimit shkollor, si dhe shpenzime rrugore për tu dërguar në praktikë nga Akademia ushtarake. Të drejtat dhe obligimet e posaçme mes studentëve/kadetëve dhe Akademisë ushtarake rregullohen me marrëveshje në pajtim me Ligjin për Akademi ushtarake dhe Statutin e Akademisë ushtarake. Pas përfundimit të shkollimit studentët/kadetët dalin me rangun nëntor nga gjinia përkatëse dhe pranohen në shërbim në Armatën e Republikës së Maqedonisë së Veriut, gjegjësisht në punë në Ministrinë e Mbrojtjes.





Duke iu referuar sfidave të përgjithshme të paraqitura nga pandemia e tanishme në nivelin global, Bosković nënvizoi rëndësinë e angazhimit të forcave të armatosura për të mbështetur institucionet shtetërore dhe qytetarët, dhe shfrytëzoi rastin për të shprehur mirënjohjen për Ministrin Sllovake për dhurimin e vendit të tij në Qendrën Klinike të Malit të Zi, te paisjeve kunder COVID-19.



MINISTRI I MBROJTJES I SLLOVAKE, JAROSLAV NADA, NË PODGORICË

# Bashkëpunim me Sllovakinë në fushën e industrisë së mbrojtjes

*Jaroslav Nada: “Mali i Zi mund të japë një shembull për vendet e tjera të rajonit që aspirojnë të bëhen anëtare të NATO-s”*

Ministri i Mbrojtjes, Predrag Bozsković, u takua me 24 gusht 2020, me Ministrin e Mbrojtjes së Republikës Sllovake, Jaroslav Nada, i cili është për një vizitë zyrtare në Mal të Zi.

Bosković theksoi karakterin miqësor të marrëdhënieve midis Malit të Zi dhe Sllovakisë, i cili u forcua gjithashtu nga aleanca brenda NATO-s, përmes një kontributi aktiv për sigurinë dhe stabilitetin në Europë dhe në nivel global.

“Vizita e sotme e z. Nada është një konfirmim i miqësisë së singertë midis dy vendeve dhe gjithçka që Sllovakia ka bërë në 14 vitet e fundit. “Ne diskutuam për shumë tema me interes për të dy vendet dhe u pajtuam që ka hapësirë për forcimin e bashkëpunimit në fushën e industrisë së mbrojtjes, si dhe në stërvitjet ushtarake në Mal të Zi dhe Sllovaki, të cilat rrisin kapacitetin e forcave të armatosura”, -tha ministri. Lidhur me kete ministri i Sllovakisë Nada tha se: “Prodhuesit sllovake të mbrojtjes janë shumë të interesuar të bashkëpunojnë me partnerët e tyre malazez. Kjo është arsyeja pse ne mirëpresim çdo iniciativë për të marrë përpara bashkëpunimin tonë në këtë fushë, e cila do të kontribuojë në forcimin e kapaciteteve mbrojtëse të të dy vendeve.”

Te dy ministrat diskutuan edhe zgjedhjet, duke thënë se ishte e rëndësishme që procesi të ishte i drejtë dhe korrekt, pa ndërhyrjen e palëve të treta, në mënyrë që të shprehin vullnetin e vërtetë të qytetarëve.



“Ne jemi dëshmitarë që në vitin 2016 kemi pasur ndërhyrjen e palëve të treta dhe tani ekziston ajo, por Mali i Zi ka institucione që mund t’i përgjigjen

sfidave të tilla në një mënyrë cilësore”, - tha Bosković.

Kurse kolegu i tij sllovak dëshiroi që dita e zgjedhjeve të kalonte pa

incidente.

“Sigurisht që ne gjithashtu kemi përvojat tona me ndërhyrjen e palëve të treta. Kishte veprime të mediave të ndryshme dezinformuese kundër interesave të politikës së jashtme të Sllovakisë”, - tha Nada, duke theksuar se mandatet e tre diplomatëve rus u ndërpre, sepse nuk respektonin protokollet diplomatike.

Ai kujtoi se e njëjta gjë ndodhi me një diplomat rus në Austri sot.

“Ne pamë se çfarë ndodhi në Mal të Zi në vitin 2016, dhe duhet të pozicionohemi për të mos lejuar ndërhyrjen e palëve të treta. Unë gjithashtu duhet të them se besimi në Zot është çështje personale dhe nuk është e drejtë nëse kisha dëshiron të ndikojë në politikën e brendshme”, -tha ministri Jaroslav Nada, duke shtuar se ministrinë e mbrojtjes të të dy vendeve kanë marrëdhënie miqësore dhe bashkëpunim cilësor dypalësh.

Nada tha se Mali i Zi ka treguar veten të jetë një partner i besueshëm në komunitetin Euro-Atlantik dhe theksoi rolin e saj konstruktiv në ruajtjen e stabilitetit në Ballkanin Perëndimor,

duke thënë se Mali i Zi mund të japë një shembull për vendet e tjera të rajonit që aspirojnë të bëhen anëtare të NATO-s.

Ministri sllovak tha se vendi i tij do të vazhdojë të mbështesë fuqishëm Malin e Zi në përmbytjen e qëllimeve nga agjenda e integritimit evropian, me dëshirën që së shpejti të bashkohet me familjen evropiane dhe kështu të përfundojë realizimin e suksesshëm të prioritetëve të saj të politikës së jashtme.

Duke iu referuar sfidave të përgjithshme të paraqitura nga pandemia e tanishme në nivelin global, Bosković nënvizoi rëndësinë e angazhimit të forcave të armatosura për të mbështetur institucionet shtetërore dhe qytetarët, dhe shfrytëzoi rastin për të shprehur mirënjohjen për Ministrin Sllovake për dhurimin e vendit të tij në Qendrën Klinike të Malit të Zi, te paisjeve kunder COVID-19.

Gjatë vizitës në Malin e Zi, Ministri i Mbrojtjes së Republikës Sllovake, Jaroslav Nada, u takua edhe me Presidentin Milo Đukanović dhe Kryeministrin Duško Marković.

## Sllovakia ka mbështetur anëtarësimin e Malit të Zi në NATO

Kryetari i Parlamentit të Malit të Zi, Ivan Brajović, priti me 24 gusht 2020, ministrin e Mbrojtjes së Republikës Sllovake, Jaroslav Nada. Brajović theksoi se Mali i Zi dhe Republika Sllovake kanë ndërtuar marrëdhënie të shkëlqyera ndërshtetërore dhe bashkëpunim domethënës, që është një konfirmim i një partneriteti dhe angazhimi të fortë për forcimin e mëtutjeshëm të bashkëpunimit të përgjithshëm.

“Sllovakia ka qenë gjithmonë në anën e Malit të Zi, duke mbështetur në mënyrë aktive anëtarësimin tonë në Aleancë dhe integrimin Evropian, si një mik dhe partner i vërtetë. Mali i Zi ka arritur rezultate të shkëlqyera në mandatin e fundit, me një politikë të qëndrueshme, e orientuar nga Evropa, e cila synon



të forcojë dhe modernizojë këtë vend dhe të fitojë mbështetje bindëse nga qytetarët e Malit të Zi në zgjedhjet e ardhshme”, -theksoi Brajović.

Ministri Nada tha se duke njohur përparimin e bërë në Mal të Zi, Sllovakia ka mbështetur vazhdimisht anëtarësimin e Malit të Zi në NATO dhe procesin e integritetit në Bashkimin Evropian që nga pavarësia.


“Ne të gjithë në Bashkimin Evropian shohim punën e shkëlqyeshme që keni bërë në përmbytjen e kriterëve evropiane dhe shpresojmë që ju të vazhdoni të njëjtën politikë pas zgjedhjeve. Sllovakia do të vazhdojë të mbështesë përparimin e mëtutjeshëm të Malit të Zi edhe më intensivisht, dhe ne jemi të bindur

që gjatë këtij mandati të Parlamentit Evropian, ju do të jeni kandidati më i përgatitur dhe anëtari tjetër i Bashkimit Evropian”, -theksoi ministri Nada.

Ministri Nada theksoi se anëtarët e Bashkimit Evropian dëshirojnë që zgjedhjet në Malin e Zi të jenë paqësore dhe të sigurta, pa ndërhyrje dhe incidente të organizuara të një “palë të tretë”, siç ishte rasti në zgjedhjet parlamentare të vitit 2016.

Bashkëbiseduesit përshëndetën bashkëpunimin në fushën e mbrojtjes, dhe ministri Nada vlerësoi veçanërisht aktivitetet e ushtarëve malazezë në misionin e përbashkët të dy vendeve në Letoni brenda NATO-s.





“Verën Trake - 2020” kryen detyra të planifikuara dhe të kryera në fushën e përgatitjes. Midis tyre ishte një fluturim ulje ajri nga ajri (ngarkesat dhe parashutistët), veprimet e ekuipazheve të helikopterëve për të tërhequr viktimat dhe për të kryer një evakuim mjekësor ajror, dhe të tjerët.



NË AEROPORTET PLOVDIV, KRUMOVO DHE ÇESHNEGIROVO

# Zhvillohet stërvitja bullgaro-amerikane “Vera Trake-2020”

*Përgatitjet bullgaro-amerikane vazhdojnë në shtator me stërvitjen “Hirushja Trakia 2020” me pjesëmarrjen e avionëve luftarak*

Më se 1000 ushtarë nga ushtritë bullgare dhe amerikane stërviten bashkë në “Verën Trake -2020”. Ata kanë demonstruar desant në të cilin morën pjesë aeroplanë amerikanë C-130 “Herkules”, aeroplanë bullgarë “Spartan”, gjuajtës “MiG-29”, helikopterë “Kugër” dhe “Mi-17”. Bashkë me Forcat Ushtarake Ajrore përvojën e tyre përsosin parashutistët nga Komanda e Përbashkët për Operacione Speciale. Stërvitja ka filluar me 19 gusht dhe ka zgjatur deri më 28 gusht në rajonin e aeroporteve Plovdiv, Krumovo, Çeshnegirovo dhe në zona të ndara përkohësisht nga hapësira ajrore e Bullgarisë.

Shefi i Mbrojtjes Admirali Emil Eftimov tha se: Niveli i trajnimit të përbashkët po rritet. “Niveli i trajnimit të përbashkët midis llojeve të Forcave të Armatosura dhe komandave të Ushtrisë Bullgare, si dhe me aleatët dhe partnerët tanë, është në rritje.” Këtë e tha shefi i Mbrojtjes Admirali Emil Eftimov me, 19 gusht, pasi shikoi demonstrimet e aftësive gjatë ditës së mediave të stërvitjes bullgaro-amerikane “Vera Trake 2020”, e cila u zhvillua në zonën e Aeroportit Cheshnegirovo, Plovdiv dhe Krumovo. Admirali Eftimov falënderoi komandantët e Forcave Ajrore (Forca Ajrore) dhe Komandën e Përbashkët të Operacioneve Speciale (JCC) për demonstrimin e shkëlqyeshëm.

Përpara mediave, shefi i mbrojtjes theksoi se stërvitja është mbajtur që nga viti 2007. Komplexiteti i trajnimeve të përbashkëta është rritur me secilin vit që kalon, në mënyrë që manovrat e tilla komplekse të demonstrohen sot.

“Niveli ynë i pajtueshmërisë, i zbatimit të përbashkët të detyrave në një shkallë dypalëshe dhe koalicioni, mban një ritëm të rëndësishëm. Shpresoj se do ta ruajmë dhe do ta përmirësojmë me kalimin e viteve”,- tha Admirali Eftimov. Ai theksoi se përgatitjet bullgaro-amerikane vazhdojnë në shtator me stërvitjen “Hirushja Trakia 2020” me pjesëmarrjen e avionëve luftarak. Pas demonstrimeve të suksesshme, komandanti i Forcave Ajrore bullgare, gjeneralmajor Tsanko Stoykov, tha se demonstrimet e tanishme janë vetëm një pjesë e mundësive dhe operacioneve që janë duke u realizuar. Komandanti i SCSSO, Gjeneral Major Yavor Mateev, theksoi se forcat speciale punojnë si një makinë e naftës së mirë me forcat e tjera të armatosura të Bullgarisë dhe Shteteve të Bashkuara. Pjesëmarrësit në “Verën Trake - 2020” kryen detyra të planifikuara dhe të kryera në fushën e përgatitjes. Midis tyre ishte një fluturim ulje ajri nga ajri (ngarkesat dhe parashutistët), veprimet e ekuipazheve të helikopterëve për të tërhequr viktimat dhe për të kryer një evakuim mjekësor ajror, dhe të tjerët.



## Helikopteri Mi-17 ndërhyr në shuarjen e zjarrit në Svilengrad

Një helikopter Mi-17 nga Forca Ajrore mori pjesë në shuarjen e zjarrit në komunën e Svilengrad. Helikopteri Mi-17 u ngrit në orën 2.38 pasdite, në datë 23 gusht, nga Baza Ajrore e Krumovës për të ndihmuar njerëzit të vunë zjarrin pyll që shpërtheu mes fshatrave Studena dhe Dervishka Mogila në Komunën Svilengrad, Qarku Haskovo. Ekuipazhi me katër anëtarë, i komanduar nga Major Slavchev, kishte për detyrë të ndërhynte mbi pyje nga ajri duke përdorur sistemin e zjarrfikësve “kova bambi” me të cilin është i pajisur helikopteri. Zjarri nisi nga shkëndija e një traktori gjatë pastrimit të një kullote, transmetoi BNR. Prognoza meteorologjike evidenton indeksin ekstrem për rrezik nga zjarri në 9 krahina të Bullgarisë. Keshtu Instituti Kombëtar i Meteorologjisë dhe Hidrologjisë shpalli një indeks ekstrem rrezikut nga zjarri në 9 zona: të rrezikuara nga stuhia e zjarrit si: Veliko Tërnovo, Ruse, Silistra, Tërgovishte, Burgas, Sliven, Stara Zagora, Haskovo dhe Jamboll. Indeksi ekstrem i rrezikut do të thotë rrezik zjarri që përhapet shumë shpejt.



## Forca Tokësore: Tridhjetë e nëntë ushtarakë bëjnë betimin

Tridhjetë e nëntë ushtarakë të caktuar në formacionet ushtarake të Forcave Tokësore u betuan në detyrë. Pesëmbëdhjetë ushtarakë të caktuar në Regjimentin e 101-të të Alpeve në Smolyan, katërmëdhjetë në divizionin kundër raketave të Brigadës së 2-të të Mekanizuar në Pleven, dhe dhjetë në Batalionin e 78-të të Sigurisë në Sofje u betuan me, 21 gusht. Në një atmosferë solemne ata u betuan të shërbenin me besnikëri dhe përkushtim ndaj atdheut. Komandantët e formacioneve ushtarake të Forcave Tokësore në Smolyan dhe Sofje, kolonel Dimitar Katsarov dhe major Alexander Boykov, si dhe zv / komandanti për Mbështetjen Logjistike të Divizionit të Raketave Anti-Aeroplan në Pleven, Major Kiril Kirov, uruan ushtarakët në radhët e Forcave Tokësore të cilët do të punojnë me nder, përkushtim dhe profesionalizëm.

## Shkatërrohet predha e paeksploduar 85 mm me një siguresë

Një ekip i specializuar i Forcave Tokësore neutralizoi municionin e gjetur në fushat afër qytetit Pleven. Një ekip i specializuar i Forcave Tokësore u aktivizua me, 20 gusht, me detyrën e zbulimit dhe shkatërrimit të mjeteve të paeksploduar të gjetura në nivelet 2 km në jugperëndim të Pleven. Gjatë inspektimit, ushtarakët e Regjimentit të 55-të të Inxhinierëve në Belene zbuluan se bëhej fjalë për një predhë 85 mm me një siguresë. Predha u shkatërrua në përputhje me të gjitha masat e sigurisë.





# Hartat e parapërmytjes

## Ja provat e qytetërimeve të përparura, përpara historisë së shkruar


**S**i është e mundur që ka harta të lashta, prehistorike, që paraqesin rajone të planetit tonë, si Antarktida pa akull, dhe që janë krijuar mijëra vite më parë? A u përkisnin këto harta qytetërimeve përpara përmytjes së madhe, të cilët banonin planetin tonë që përpara historisë së shkruar?

Periodha Antediluviane, është periodha përpara përmytjes së madhe. Në bibël, kjo periudhë është ndërmjet rënies së njeriut dhe përmytjes së Noas, ose historisë së përmytjes së madhe, siç rrëfëhet tek Gjenezja. Megjithatë, historitë për një përmytje të madhe nuk janë të pranishme vetëm në Bibël, por ato mund të gjenden në besime të ndryshme fetare, me origjinë mijëra vite më parë.

Në fakt, rrëfimet më të hershëm të një përmytje të madhe i gjen tek Sumerët e lashtësisë, dhe deri në vitin 200 para Krishtit. Tekstet e lashtë të gjetur në tabletat e argjilës të Sumerëve jo vetëm përshkruajnë një histori Antediluviane, por flasin edhe për krijimin e njeriut, dhe se si “perënditë” ndërhyjnë në mënyrë të pabesueshme:

“Nuk kishin kaluar as dyqind vite, kur toka u zgjerua dhe njerëzit u shtuan. Toka ziente si një dem. Zoti u shqetësua nga zhurma e tyre. Enlili e dëgjoi poteren e tyre.

Dhe u tha Zotave të mëdhenj: ‘Zhurma e njerëzimit është bërë shumë e fortë për mua. Me poteren e tyre, më lënë pa gjumë. Ndërprija furnizimet njerëzve. Le të ketë mungesa të jetës në planet, që të mso kënaqet oreksi i tyre. Adadi [tjetër ëngjëll mbrojtës] duhet të ndërpresë shiun e tij, dhe poshtë, vërshimet [vërshimet e rregullt të ujërave që e bënin tokën pjellore] nuk duhet të ngrihen nga humnerat. Të fryjë era dhe të thajë tokën. Të trashen retë, por të mos lëshojnë shira. Të pakësohen të korrat e tyre. Të mos ketë gëzim mes tyre!a vlen të përmendet që, sipas tabletëve sumerianë, pak përpara se përmytja e madhe të godiste tokën, “Zotat” e lanë planetin për të qenë të sigurt “në qiej”, e për t’u rikthyer pas përmytjes. Këto histori që zakonsht quhen “mite” nga studiuesit, flasin për një kohë kur planetin tonë e banonin qytetërime të ndryshme, me kultura dhe popuj që jetonin mbi Tokë përpara



**1531: Harta e Oronteus Finaeus tregon Antarktidën, përpara se të zbulohet dhe si ajo dukej pa akull. Harta tregon lumenj, lugina dhe male...**

se historia të shkruar, një periudhë e humbur ngjarjesh prehistorike, mbetet e të cilës po i rigjejmë dalëngadalë sot.

Por historitë e Përmytjes së Madhe nuk janë e vetmja provë që mbështet teorinë se qytetërime të përparuar kanë qenë këtu shumë kohë përpara nesh. Ka edhe shumë zbulime të tjera që mbështet idenë e qytetërimeve antediluviane. Fakti që ka shumë sende të zbuluara në të gjithë planetin, tregon se historia, ashtu si na është mësuar, është krejt gabim.

Harta si ajo e Piri Reis janë vërtetuar nga studiuesit, të cilët kanë mbetur të shatisur dhe nuk mund ta shpjegojnë saktësinë e tyre dhe nivelin e detajeve. Disa prej tyre janë krijuar sikur dikush ka qenë në gjendje ta shohë tokën nga lart, përpara se të realizonte hartat...

Ia vlen të përmendet se harta e Piri Reis u krijua bazuar në harta të tjera shumë më të vjetra, nga rajone të ndryshme përreth botës. Po çfarë

na thonë hartat si ajo e Piri Reis? Ato ofrojnë prova të forta se në të kaluarën e largët, qytetërime me dije kartografike të pabesueshme, kanë ekzistuar mbi Tokë. Duket se këta qytetërime të lashtë kishin parë pjesë të botës, që sot janë të mbuluara me akull: Antarktida për shembull, që do të thotë se cilido që i krijoi këto harta, duhet t’i ketë parë këto pjesë të botës atëherë kur klima ishte shumë ndryshe, një periudhë e historisë së planetit tonë që i paraprin epokës së fundit të akullit. Harta e Piri Reis u krijua rreth vitit 1520 dhe përveç se shfaq Antarktidën pa akull, ajo paraqet me saktësi gjeografinë e Kontinentit Amerikan me një saktësi të tillë, sa që duket se është bërë me ndihmën e fotografimeve ajrore. Është interesante që kjo hartë u ekzaminua prej Zyrës hidrografike të Marinës së SHBA dhe vërtetësia e saj u konfirmua. Harta u konsiderua e saktë dhe e vërtetë e madje u përdor edhe për të korrigjuar

gabime në hartat moderne.


Por... kush e krijoi hartën e Queen Maud Land në Antarktidë, 6000 vjet më parë? Cili qytetërim i njohur e kishte teknologjinë, apo nevojën për ta bërë këtë?

Informacioni gjeografik që përmban harta tregon se një pjesë e materialit burimor të saj i përket 5000 viteve më parë. Ndërkohë që Piri Reis nuk është një hartë që besohet se i paraprin përmytjes së madhe, ajo është krijuar duke përdorur harta që janë më shumë se 5000-vjeçare.

Një letër interesante e Zyrës së Marinës flet për hartën e Piri Reis, ku kapiteni lorenzo Burroughs shkruan: Përputhja e hartës së Piri Reis me profilin sizmik të kësaj zone, të realizuar nga ekspedita norvegjezo-britaniko-suedeze në vitin 1949, të bën të mbërrish pa asnjë dyshim, në konkluzionin që hartat origjinale që kanë shërbyer si burim duhet të jenë

realizuar përpara se sa mbulesa e akullit e Antarktidës mbuloi brigjet e Queen Maud Land. Megjithatë, tërheqin vëmendjen harta të tjera, si Zeno, e cila i paraprin hartës Piri Reis, ku shfaqen qartë brigjet e sotme të Norvegjisë, Suedisë, Danimarkës, Skocisë dhe Gjermanisë. Vec kësaj, hartat Zeno përfshijnë gajtësinë dhe gjerësinë e saktë gjeografike të një numri ishujsh. Përse është kjo e rëndësishme? Sepse që të përcaktosh gjatësinë, duhet të përdorësh kronometër, një pajisje që u shpik në vitin 1765. Edhe më e pabesueshme, harta Zeno duket se paraqet topografinë e Groenlandës së sotme, pa akullnaja, që do të thotë se dikush e ka parë Groenlandën përpara epokës së akullit. “Duket se informacion i saktë është përcjellë mes njerëzve. Duket se hartat e kanë fillësën tek një popull i panjohur dhe ato janë përcjellë, ndoshta nga minoanët dhe fenikasit, të cilët për më shumë se një mijë vite ishin lundërtarët më të mirë të botës së lashtë. Ne kemi prova se ato janë grumbulluar dhe studiuar në librarinë e madhe të Aleksandrisë dhe përmbledhjet e tyre janë kryer prej gjeografëve që kanë punuar aty. Edhe më të rëndësishme janë hartat e krijuara nga Iehudi Ibn ben Zara. Harta e tij e realizuar rreth vitit 1487 paraqet disa rajone të Britanisë të mbuluar me akuj. Harta paraqet edhe ishuj në Detin Mesdhe dhe Egje. Këta ishuj ekzistojnë ende sot, por vetëm nën ujë, duke lënë të kuptohet se cilatdo harta që janë përdorur për të krijuar grafikët kartografikë të 1487-ës, ato janë të një kohe kur gjeologjia e planetit tonë ishte shumë ndryshe, domethënë një kohë përpara përmytjes së madhe.

Këto harta të lashta ofrojnë shumë enigma dhe pikëpyetje dhe shumë pak në mos aspak përgjigje, që do të thotë që në një të kaluar të largët, mbase 10000-12000 vite më parë, ekzistonin qytetërime të përparuar në Tokë, të cilët kishin ngritur qytete të pabesueshëm, kishin arritur gjëra të mëdha, dhe kishin eksploruar planetin me një saktësi të jashtëzakonshme.





# U realizua nga hartografi gjovanez Bartolomeo Pareto

## Ja harta e rrallë Detare e Arbërisë e vitit 1455

*Harta e rrallë e vitit 1455 është realizuar nga hartografi gjovanez Bartolomeo Pareto për Papa Nikollën V dhe ka të bëjë me historinë kartografike të Arbërisë*

U ekspozua para dy vitesh në Qendrën për Hapje edhe Dialog në kryeministri harta Detare e vitit 1455, e cila ka udhëtuar për herë të parë jashtë Italisë, falë pasionit të studiuesit të hartografisë mesjetare Artan Shkreli. Kjo hartë e rrallë e vitit 1455 është realizuar nga hartografi gjovanez Bartolomeo Pareto për Papa Nikollën V dhe ka të bëjë me historinë kartografike të Arbërisë. Bartolomeo Pareto ishte një prift mesjetar dhe hartograf nga Xhenova.

“Në atë periudhë kur është punuar harta nga hartografi gjovanez Bartolomeo Pareto, hartat ishin kopje unike dhe bëheshin me dorë, sidomos portulanët që janë të rralla për dy motive. E para, sepse difuzioni ka qenë shumë i vështirë. Edhe e dyta, sepse ruhej sekreti i bërjes së hartave portulane, ekskluziviteti i të cilave ka qenë në tre pika. E para, në Majorka të Spanjës, që ishte një qendër e prodhimit të hartave, në Venecia edhe në Gjenova. Në fakt këto ishin edhe tre fuqitë detare të kohës. Dy republikat italiane, Venecia me Gjenovën dhe Spanja, që ishte një fuqi e fortë detare”, sqaron arkitekti dhe studiuesi i hartografisë mesjetare, Artan Shkreli, i cili pas shumë përpjekjesh arriti ta sjallë hartën për herë të parë nga Italia dhe ta ekspozojë për dy javë në Tiranë.

“Në parjen e qindrave hartave, sipas katalogimeve ndërkombëtare ruhen rreth 350 harta detare, rashë edhe në studimin e kësaj harte. Kryesisht në studimin e bregdetit shqiptar, sepse shpeshherë gjurmët që janë lënë në histori janë ruajtur në toponimin e bregdetit shqiptar. Bota pjesën brenda, tokën, e njihte më pak. Më shumë njihte bregdetin. Prandaj, informacionin që merrej nga bregdeti ka qenë shumë më i rëndësishëm se informacioni që merrej Brenda në tokë”, - sqaron Shkreli.

Jemi në një vit shumë të rëndësishëm të historisë së Europës, të cilat do të përcaktojnë gjeografinë, por edhe historinë e komitentit tonë, minimalisht për III apo IV shekujt e ardhshëm. Ky është një moment, kryqal, sepse është nga njëra anë Europa po rifiton pozicionet e saj në Spanjë, duke i përzënë arabët nga Spanja, të cilën ata e zotëronin për VI apo VII shekuj, por nga ana tjetër janë duke marrë pjesën juglindore të Europës, Gadishullin Ballkanik përmes inkursioneve të shumta pushtuese. Harta është e vitit 1455 e përgatitur nga Bartolomeo Pareto, i cili ishte një njeri i afërt i Papa Nikollës V. Në këtë pjesë të hartës shquhet stema e Nikolla V dhe pasaporta e hartës, ku shënohet se Bartolomeo Pareto përgatiti këtë hartë për Nikolla V në vitin 1455 në Gjenovë. Dyshimet kur rashë në këtë hartë për të lexuar një



toponim në brenda tokën arbërore ishin shumë të forta, bëhej fjalë për emrin e heroit tonë kombëtar.

Hartë Detare e vitit 1455 ruhej në Bibliotekën Kombëtare Qendrore të Romës.

“Ka qenë një emocion i paparë kur vërtetova që në qendër të Ballkanit Jugor, midis Shqipërisë së sotme dhe Maqedonisë së sotme ishte shkruar Scanderbeco (Skënderbeu), që është emri me të cilin Gjergj Kastrioti njihej si luftëtar i madh”, - thotë Shkreli.

Studjuesi Shkreli në intervistën e dhënë për shtypin e kohës, me rastin e ekspozimit të hartës në Tiranë, thotë se: “Kjo më bëri shumë çudi, sepse është hera e pare, që unë has, që në një hartë portulane, por qoftë edhe hartë gjeografike tjetër, të identifikohet një territor i gjerë me emrin e një njeriu. Kjo nuk ndodh, nuk ekziston. Mund të ketë ndonjë shembull të vogël në epokën e zbulimeve gjeografike, që ndonjë gadishull apo ishull mund të merrte emrin e zbuluesit, në vitin 1700-1800. Kjo ka të bëjë me zbulimin, por emri i një ushtaraku dhe regjenti të mbretërisë së Arbërit, Epirit dhe Maqedonisë, të shënohet në një territor gjeografik, ky është një rast unik.

E vetmja paralele që mund të bëjë unë, por që krejt për motive të tjera është emri i Amerucio Vespucio, të cilit iu dha pasi zbuloi se Amerika nuk ishte India, por ishte një kontinent tjetër.

Në këtë pikëpamje harta është unike për historinë tonë, por edhe për shkencat albanologjike. Jo vetëm nga pikëpamja krosheore, por vërtetohet

atë që shqiptarët e dinë shumë mirë, por që dimitizuesit janë përpjekur ta shkatërrojnë, se Skënderbeu nuk ishte një mit, apo për më tepër nuk ishte një mit, apo një gënjeshtër apo falsifikim që u ndërtua pas vdekjes së tij nga fuqitë e kohës, që u munduan ta evo-

kojnë për interesat e veta. Nuk ishte një gjë e shpikur nga venedikasit, apo austro-hungarezët apo u përdorë nga fashistët, apo komunistët. Ai ishte një fenomen historik me impakt europian në të gjallë të tij. Edhe me një impakt shumë më të madh sa mund të men-



dohej, sa të zërë vend në një kohë reale në një hartë gjeografike. Gjë e rrallë, që nuk ndodh! Edhe ngjarje shumë të rëndësishme në harta gjeografike reflektohen disa vite apo disa dekada më vonë. Në këtë hartë para dy vitesh kishte rënë Kostandinopoja edhe nuk ekziston asnjë flamur me të, ndërsa qytetet kryesore janë të gjithë me flamuj. Sepse, Europa nuk ishte e bindur, ose gjeografët nuk ishin të bindur, që t'i jepnin vulë osmane këtij qyteti, sepse mendonin se shumë shpejt një kryqëzat do ta rifitonte qytetin e humbur.

Flamujt osmanë mbi Kosnadinopojë shfaqen disa vite më pas, ndërsa emri i Skënderbeut shfaqet në kohën reale, në vitin 1455. Kur Papa Nikolla fillon bën atributet për t'i dhënë emrin mbret Skënderbeut. Por kjo ndërpritet nga vdekja e Nikolla V-të, i cili vdes në pranverën e këtij viti që bëhet harta. Praktik që e rimerr më vonë Papa Piu i II-të, i cili ishte edhe një humanist i madh i Rilindjes Europiane, por që edhe ai në momentin që shkon për siguruar mbret vdes në Ancona gjatë rrugës së tij për të shkruar në Dalmaci. Moment që do të bëhej frontizimi i Gjergj Kastriotit mbret i Arbërisë, Maqedonisë dhe Epirit. Në këtë pikëpamje ne kemi dëshminë e gjallë, unike edhe të papërsëritshme në këtë hartë, se Skënderbeu (Scanderbeco) është një mur mbrojtës i vlerave të vjetra europiane.

Kjo hartë nuk e ndryshon historinë, ose të paktën historinë e Skënderbeut që njohim ne. Por kjo vetëm përforcon idenë e madhështisë nga njëra anë, edhe dimensionit shumë më të madh, sesa dimensionit arbëror i kësaj figure, që është një figurë europiane.

Skënderbeu mbetet një figurë qendrore arbërore, i cili bazën e ushtrisë së vet, të qëndresës dhe kryesisht popullin që udhëhoqi edhe ku u mbështet të ishin arbërit. Ai bëri të mundur që në almanakun e Gutenbergut, dokumentin më të rëndësishëm i kohës: “Albanezet, shkruan ai në gjermanishten e kohës, janë nga popujt qendror të Europës, të cilët ishin vënë pararojë në mbrojtje të rrezikut osman”. Me Skënderbeun, Arbëria, shqiptarët dalin vullshëm në teatrin e historisë. Më parë Albania ishte një ekspresion gjeografik, si Dalmacia apo Thraka, sepse pak njohje kishte për popullin që jetonte në këtë territor. Ndërsa, me Skënderbeun populli bëhet më i rëndësishëm se territori i vet, të qenit albanez në atë kohë është një pasaportë qytetarie, nderi në Europën e Shekullit XV. Natyrisht që jehona vazhdon edhe më vonë”.





## KUFIRI UJOR NDËRSHTETËROR LIQENOR ME MALIN E ZI

# Helikopteri "Cougar" i Forcës Ajrore në operacionin për vendosjen e bovave në liqenin e Shkodrës

Kufiri mes Shqipërisë dhe Malit të zi në liqenin e Shkodrës përcaktohet nga 21 bova, të cilat për shkak të kushteve atmosferike dhe mungesës së mirëmbajtjes ishin dëmtuar dhe nuk ekzistojnë prej vitesh. Sipas marrëveshjes mes dy qeverive, pala shqiptare është përgjegjëse për instalimin dhe mirëmbajtjen e 11 bovave, ndërsa pala malazeze për 10 të tilla. Dy vitet e fundit pala jonë ka bërë rivedosjen e 8 shenjave të reja ujore në kufirin me Malin e Zi në liqenin e Shkodrës, ndër të cilat 3 me sinjal ndriçues për natën.

